

**MJETET E PRAKTIKUESIT NË KUADËR TË UDHËRRËFYESIT**


**DIREKTIVA PËR INTERPRETIM DHE PËRKTHIM**

**VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR PËRKTHIM**

**CILËSIA E INTERPRETIMIT NË STACIONIN POLICOR**

**ÇËSHTJA E "GJUHËS SË TRETË"**

**PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE ESENCIALE**



## Për Fair Trials

Fair Trials Europe ("Fair Trials") është organizatë joqeveritare që punon për gjykime të drejta sipas standardeve të drejtësisë të njohura ndërkombëtarisht. Vizioni ynë është një botë ku respektohet e drejta e çdo personi për një gjykim të drejtë, pavarësisht kombësisë së tyre, kudo që ata akuzohen.

Fair Trials u ndihmon njerëzve të kuptojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre për gjykim të drejtë; adreson shkaqet rrënjësore të padrejtësisë përmes punës së saj të reformës ligjore; dhe zhvillon trajnime të synuara dhe aktivitete të rrjetëzimit për të mbështetur avokatët dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut në punën e tyre për të mbrojtur të drejtat për gjykim të drejtë.

Duke punuar me Panelin Këshillëdhënës të Ekspertëve Ligjorë ("LEAP") - një rrjet prej më shumë se 140 ekspertëve të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut, duke përfshirë avokatë mbrojtës, OJQ-të dhe akademikët nga 28 Shtete Anëtare të BE-së –Fair Trials ka kontribuar në negociatat rreth miratimit të tri direktivave sipas Udhërrëfyesit për përforcimin e të drejtave procedurale.

LEAP, i mbështetur nga Fair Trials, tani po angazhohet për të siguruar zbatimin efektiv të Direktivave, në vazhden e strategjisë së saj të, Drejt një Lëvizjeje të BE-së për të Drejtat e Mbrojtjes, të shkurtit të vitit 2015 duke përfshirë trajnimin e praktikuesve dhe çështjeve gjyqësore në gjykata kombëtare dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

## Kontakti

### Libby McVeigh

Drejtor Ligjor dhe Politika

Fair Trials International

+44(0)2078222370

[libby.mcveigh@fairtrials.net](mailto:libby.mcveigh@fairtrials.net)

### Alex Tinsley

Zyrtar Ligjor dhe Politika

Fair Trials Europe

+32 (0)2 743 85 93

[alex.tinsley@fairtrials.net](mailto:alex.tinsley@fairtrials.net)

## Falënderimet

Fair Trials dëshiron të falënderojë anëtarët e LEAP për sigurimin e informatave mbi të cilat është bazuar ky Manual. Po ashtu dëshirojmë të falënderojmë James Brannan (përkthyes, anëtarë i LEAP) dhe Cyril Joyce (interprete) për kontributin e tyre, dhe anëtarët e LEAP Ellen Moerman dhe Liese Katschinka, presidente e Shoqatës Evropiane të Përkthyesve dhe Interpretëve Ligjorë (EULITA) për kontributin e tyre të vazhdueshëm për LEAP në lidhje me pyetjet për asistencë gjuhësore. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë tonat.

Me mbështetje financiare nga:



Bashkë-financuar nga Programi për Drejtësi  
penale i Komisionit Evropian



CLIFFORD  
CHANCE

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
<b>HYRJE.....</b>	<b>5</b>
A. HYRJE.....	5
1. Historiku dhe materialet e tjera trajnuese të Fair Trials.....	6
2. Fushëveprimi i manualit .....	6
3. Si të përdorim këtë Manual .....	6
a. Si është e organizuar përmbajtja.....	6
b. Manuali “Përdorim i të Drejtës së BE-së në Praktikë” .....	7
c. ‘Interpretimi’ dhe ‘përkthimi’ .....	7
d. Një fjalë kujdesi.....	7
e. Mbani kontaktin .....	8
B. PARA DIREKTIVËS: RISHIKIMI I PARIMEVE TË KEDNJ .....	8
C. PËRMBLEDHJE E DIREKTIVËS.....	10
1. Vështrim.....	10
2. Qëllimi dhe objektivat .....	12
3. E drejta për interpretim dhe përkthim .....	13
<b>D. PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E DIREKTIVËS .....</b>	<b>13</b>
1. Ekzaminimi i ligjit dhe praktikës kombëtare në dritën e Direktivës .....	13
2. Hetimi i kontekstit lokal .....	15
a. Mësoni për standardet kombëtare të interpretimit .....	15
b. Bisedoni me kolegët/odat e avokatëve .....	15
<b>I – VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR INTERPRETIM .....</b>	<b>16</b>
A. PROBLEMI .....	16
B. BAZA E KEDNJ .....	16
1. Supozim në favor të interpretimit nëse kërkohet .....	16
2. Parametrat për vlerësimin e nevojave për interpretim.....	17
C. DISPOZITA TË RËNDËSISHME TË DIREKTIVËS.....	18
D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	19
1. Sqarimi i pozicionit në stacionin e policisë (nëse jeni aty).....	19
2. Kundërshtimi i vendimit që thotë se nuk ka nevojë për interpretim .....	19
<b>PJESA II – CILËSIA E INTERPRETIMIT NË STACIONIN POLICOR.....</b>	<b>21</b>
A. PROBLEMI .....	21
B. BAZA E KEDNJ .....	22
C. DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS .....	23

1.	E drejta për interpretim (të cilësisë së mjaftueshme) .....	23
2.	Dispozitat që lidhen me kontrollin e cilësisë.....	23
	a. Përgjigje specifike sipas rastit në lidhje me cilësinë.....	24
	b. Kërkesa të përgjithshme të kontrollit të cilësisë .....	24
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	25
1.	Pika preliminare .....	25
2.	Veprimet në fazën paragjyqësore .....	25
	a. Para se të fillojë marrja në pyetje .....	26
	i. Konsultimi me klientin para marrjes në pyetje .....	26
	ii. Hapat fillestarë.....	26
	iii. Nëse interpreti është i pakualifikuar .....	27
	b. Qasja e përgjithshme për marrje në pyetje .....	27
	i. Njoftoni klientin me problemet e interpretimit.....	27
	ii. Mbajtja e shënimeve.....	28
	iii. Çka duhet pasur kujdes – në përgjithësi.....	28
	iv. Çka duhet pasur kujdes – çështjet specifike .....	29
	▪ Pyetjet kontrolluese .....	30
	▪ Deklaratat inkriminuese .....	30
	▪ Problemet me interpretimin konsektiv .....	31
	▪ Leksiku .....	31
	▪ Interpretimi në vetën e parë.....	31
	▪ Interpreti e “këshillon” klientin .....	31
	c. Ankimi për cilësinë e interpretimit.....	31
	i. Gjatë intervistës .....	31
	ii. Pas intervistës:.....	32
3.	Paraqitja e argumenteve në gjykatë.....	32
	a. Detyra e gjykatës për të siguruar interpretim adekuat .....	32
	b. Obligimi i gjykatës në raport me interpretimin joadekuat në stacionin policor: “Ushtrimi i kontrollit” kur “vihet në dijeni” .....	32
	iii. Parimi rudimentar i “kontrollit retroaktiv” në rastin Diallo v. Suedisë .....	33
	iv. Krijimi i një detyrimi për kontroll retroaktiv sipas Direktivës .....	34
	c. Paraqitja e argumenteve.....	34
	i. Përdorni shënimet që keni marr në stacionin policor .....	34
	ii. Bazohuni në dështimin për ndërmarrjen e “masave konkrete” .....	34
	iii. Standarde të ndryshme në stacionin policor dhe në gjykatë .....	35
<b>III</b>	<b>– PROBLEMI I “GJUHËS SË TRETË” .....</b>	<b>36</b>
A.	PROBLEMI.....	36
B.	BAZA E KEDNJ .....	36
C.	DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS .....	36
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	36

1.	Kundërshtimi i një vendimi për ofrim të interpretimit në gjuhë të tretë .....	37
2.	Ankimi për interpretim joadekuat .....	37
a.	Gjatë intervistimin fillestar .....	37
b.	Në gjykatë .....	37
<b>IV</b>	<b>–PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE ESENCIALE .....</b>	<b>38</b>
A.	PROBLEMI.....	38
B.	BAZA E KEDNJ-së .....	39
C.	DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS .....	39
1.	E drejta për përkthim të dokumenteve esenciale .....	39
a.	E drejta e përgjithshme .....	39
b.	Dokumentet që janë gjithmonë esenciale / dokumentet tjera .....	40
2.	Përkthimi i pjesshëm .....	40
3.	Përgjashtimi i “përkthimit me gojë/përmbledhjes” .....	41
4.	E drejta për të kërkuar përkthim dhe e drejta për të kundërshtuar refuzimin e kërkesës ...	41
D.	PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË .....	42
1.	Identifikimi i dokumenteve për të cilat dëshironi përkthime .....	42
2.	Parashtrimi i kërkesës .....	42
a.	Elementet themelore.....	43
b.	Përmbajtja e kërkesës.....	43
i.	Unë kam të drejtë ta bëj këtë kërkesë.....	43
ii.	Dokumentet e detyrueshme .....	43
iii.	Dokumentet tjera esenciale .....	44
3.	Kundërshtimi i vendimeve negative .....	45
a.	Këmbëngulni për shqyrtim gjyqësor .....	45
b.	Arsyet e kundërshtimit.....	45
i.	Refuzimet e paarsyeshme nuk janë të pranueshme .....	45
ii.	Vendimi mbështetet në mundësinë e “përkthimit verbal” .....	46
	<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>48</b>

# HYRJE

## A. HYRJE

### 1. Historiku dhe materiale tjera trajnuese të Fair Trials / LEAP

---

Në dekadën e fundit, Shtetet Anëtare të BE-së kanë bashkëpunuar ngushtë sa i përket çështjeve ndërkufitare, kryesisht përmes Urdhrit Evropian për Arrest. Sistemet e tilla mbështeten në besimin e ndërsjellë në mes të autoriteteve gjyqësore që secila do të respektojë të drejtat e palëve të përfshira, në veçanti siç garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ').

Megjithatë, bashkëpunimi është dëmtuar nga fakti se autoritetet gjyqësore nga të cilat kërkohet që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën, në realitet nuk kanë besim të plotë tek njëra tjetra sa i përket përmbushjes së këtyre standardeve. Me qëllim të përforcimit të sistemit, BE ka filluar vendosjen e standardeve minimale për të rregulluar aspekte të caktuara të procedurës penale përmes një programi të quajtur 'Udhërrëfyesi'.<sup>1</sup>

Përderisa këto masa origjinën e tyre e kanë në sigurimin e besimit reciprok, si rezultat kemi një sërë direktivash të obligueshme për autoritetet kombëtare në të gjitha rastet, duke përfshirë edhe ato që nuk kanë elemente ndërkufitare. Ato mbulojnë të drejtën për përkthim dhe interpretim,<sup>2</sup> të drejtën për informacion,<sup>3</sup> dhe të drejtën për të pasur një avokat<sup>4</sup> (kolektivisht, 'Direktivat').

Ky Manual diskuton Direktivën 2010/64/EU mbi të drejtën për interpretim dhe përkthim në procedura penale<sup>5</sup> ('Direktiva'), e cila është dashur të transpozohet në legjislacionin vendor deri më 27 tetor 2013. Ajo rregullon të drejtën e personave të dyshuar dhe të akuzuar për të pasur përkthim me gojë (interpretim) gjatë intervistave në polici, në seanca dëgjimore dhe në takime me avokatin e tyre si dhe të drejtën për përkthimin e dokumenteve esenciale. Ky Manual duhet të lexohet së bashku me video-materialin trajnues të përgatitur nga Fair Trials<sup>6</sup>.

Kjo është një masë qendrore sepse me rritjen e lëvizshmërisë rritet edhe numri i të dyshuarve të cilët nuk flasin gjuhën lokale, dhe të cilët janë të varur në asistencë efektive gjuhësore për të qenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën të tjera, siç janë pjesëmarrja në gjykimin e tyre, bisedimi me avokatin e tyre etj.

Në mënyrë që Direktiva të arrijë qëllimin e saj, ajo duhet të referohet nga avokatët në raste individuale për të siguruar që gjykatat respektojnë standardet e saj. Ky Manual është dizajnuar për të dhënë këshilla praktike për përdorimin e kësaj Direktive në praktikë. Ky Manual duhet të lexohet së bashku me Manualin 'Përdorimi i të drejtës së BE-së në praktikën penale' dhe me video-

---

<sup>1</sup> Rezoluta e Këshillit e 30 nëntorit 2009 për Udhërrëfyesin për përforcimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar ose të akuzuar në procedura penale ([OJ 2009 C 295, p.1](#)).

<sup>2</sup> Direktiva 2010/64/EU e Parlaentit Evropian dhe e Këshillit e 20 tetorit 2010 mbi të drejtën për përkthim dhe interpretim në procedurat penale, ([OJ 2010 L 280, p. 1](#)).

<sup>3</sup> Direktiva 2012/13/EU e Parlaentit Evropian dhe e Këshillit e 22 majit 2012 mbi të drejtën për informata në procedura penale ([OJ 2012 L 142, p. 1](#)).

<sup>4</sup> Direktiva 2013/48/EU e Parlaentit Evropian dhe e Këshillit e 22 tetorit 2013 mbi të drejtën e pasjes së një avokati në procedura penale dhe në procedurat e urdhrit evropian të arrestit, dhe mbi të drejtën e informimit të një pale të tretë për heqjen e lirisë dhe për të komunikuar me persona të tretë dhe me autoritete këshilluese gjatë heqjes së lirisë ([OJ 2013 L 290, p. 1](#)).

<sup>5</sup> Shënimi 2 më lartë

<sup>6</sup> Në dispozicion në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

materialin trajnues online mbi Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.<sup>7</sup>

## 2. Fushëveprimi i manualit

Ky Manual nuk është gjithëpërfshirës. Ai mbulon çështje të caktuara të cilat janë potencuar nga anëtarët e rrjetit LEAP si një sfidë që përbëjnë një sfidë të veçantë për realizimin e mbrojtjes penale. Këto çështje përfshijnë: (I) Vlerësimin e nevojave të interpretimit; (II) Cilësinë e përkthimit me gojë (interpretimit) në stacionin policor; dhe (III) Përkthimin e dokumenteve esenciale. Nuk kemi mbuluar aspektet që lidhen me urdhër arrestin evropian, pasi kjo ka të bëjë me një gamë shumë më të ngushtë të rasteve.

Edhe shumë çështje të tjera mund të ngritën. Për shembull, në kohën e shkrimit të këtij Manuali një referim<sup>8</sup> është në pritje pranë GJDBE-së duke pyetur nëse rregulli i ligjit kombëtar që kërkon dokumentet e apelit të depozitohet në gjydhën e forumit duhet të hiqet për të zbatuar Direktivën. Ka një mori pyetjesh tjera potenciale, kështu që ne ju inkurajojmë ta trajtoni këtë Manual vetëm si pikënisje.

## 3. Si të përdorim këtë Manual

### a. Si është e organizuar përmbajtja

Pjesa më e madhe e përmbajtjes së Direktivës rrjedh nga rezultatet e jurisprudencës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ), dhe pa dyshim që një prej funksioneve kryesore të Direktivës është të artikuloj ato standarde si norma të kodifikuara, dhe t'i përdorë ato si bazë. Ngjashëm, për secilën fushë tematike, Manuali shqyrton praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së për të përcaktuar parimet të cilat i parashtron Direktiva.

Pastaj do të shqyrtojmë dispozitat e vetë Direktivës. Shumica e dispozitave të direktivës lënë hapësirë të konsiderueshme për interpretim, dhe në kohën e hartimit të Manualit<sup>9</sup> ende nuk ka ndonjë gjykim të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së ('GJDBE') për ndonjërin nga Direktivat. Prandaj në përputhje me rrethanat, ne përpiqemi ta bëjmë të qartë – duke përdorë pika (*bullet points*) në tekst – nëse bëjmë ndonjë supozim për kuptimin e tyre.

Pastaj, duke u bazuar në të kuptuarit tonë të Direktivës, ofrojmë këshilla konkrete se si të përdoret ajo në raste të caktuara. Kjo gjë përfshinë si hapa praktik (p.sh. dokumentimi dhe kundërshtimi i shkeljeve në fazën paragjyqësore) ashtu edhe hapa ligjorë (p.sh. referimi i Direktivës në gjykatë). Për të bërë një dallim të qartë ndërmjet këtyre niveleve të ndryshme të analizës:

*Dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe citimet nga rastet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut janë paraqitur të hijezuara me të verdhë, të kufizuara me një vij të vetme, për të paraqitur natyrën e tyre si minimumi i domosdoshëm. Ato janë të paraqitura me shkrim kursiv.*


<sup>7</sup> Në dispozicion në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/>.

<sup>8</sup> Kërkesa për një vendim preliminar nga Amtsgericht Laufen (Gjermani) parashtruar më 30 prill 2014 — *Procedura penale kundër Gavril Covaci* (OJ 2014 C 253, p. 22).

<sup>9</sup> Ky Manual është publikuar në mars 2015.

Dispozitat e të drejtës së Bashkimit Evropian ose citimet nga praktika gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian janë paraqitur me hijezim të gjelbër, me kufizim të dyfishtë, për të paraqitur natyrën e tyre plotësuese, dhe mundësisht si mbrojtje më e gjerë

## **b. Manuali “Përdorim i të Drejtës së BE-së në Praktikë”**

Sugjerimet nga Fair Trials mbi përdorimin e Direktivës në praktikë janë paraqitur me hijezim të kaltër, me kufi të trefishtë, për të përfaqësuar përdorimin tuaj të Direktivës në kontekstin lokal ligjor. Ne përiqemi të jemi të drejtpërdrejtë kur bëjmë sugjerime, duke përdorë simbolin ‘’.

Ky Manual duhet të përdoret së bashku me Manualin “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikë”, i cili përmban shpjegime për supozimet e bëra në lidhje me efektet ligjore të Direktivave. Gjithashtu, manuali përmban një hyrje të përgjithshme në konceptin e "thirrjes në Direktivë" duke u mbështetur në mekanizmat korrigjues siç janë pavlefshmëria e akteve procedurale, përjashtimi/shpërfillja e provave e kështu me radhë.

Kur bëjmë sugjerimin në formë të këshillës së “Fair Trials” në një rubrikë me kufizim të trefishtë dhe të hijezuar me të kaltër, ne mbështetemi në këtë qasje ndaj Direktivave në përgjithësi prandaj ju inkurajoheni që t’i referoheni Manualit “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në praktikë” në këtë aspekt. Megjithatë, ka disa pika specifike se si të mbështeteni në këtë Direktivë në veçanti. Ato kanë të bëjnë me kundërshtimin me rast të cilësisë së dobët të interpretimit para gjykatave në përputhje me parimin e “ushtrimit të kontrollit kur vihet në dijeni” që rrjedh nga rastet gjyqësore të mëhershme të GJEDNJ-së.

## **c. “Interpretimi” dhe “përkthimi”**

Në këtë Manual, kur i referohemi ‘interpretimit’, flasim për interpretimin me gojë të komunikimit me gojë. Kur i referohemi ‘përkthimit’, flasim për përkthimin me shkrim të dokumenteve të shkruara. Direktiva bënë një dallim të qartë mes këtyre dyjave, dhe ne do ta ndjekim të njëjtën qasje. Gjithashtu do ta përdorim edhe shprehjen ‘asistent gjuhësor’, shprehje kjoepërgjithshme që i referohet asistencës (me interpretim dhe përkthim) që i ofrohet dikujt që nuk flet ose nuk kupton gjuhën e procedurës.

Dallimi mes interpretimit dhe përkthimit nuk është i parëndësishëm, duke qenë se, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të dyja shprehjet janë të kombinuara pasi që Neni 6(3)(e) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ") i referohet vetëm “interpretimit” dhe, megjithëse GJEDNJ ka bërë shumë përpjekje për krijimin e një kërkesë për përkthimin e dokumenteve të caktuara (p.sh. aktakuzën) në praktikën e saj gjyqësore, është e vështirë të përcaktohen parimet, prandaj është e dobishme që të ndiqet dallimi i përdorur nga Direktiva

## **d. Kini kujdes**

Ky manual është hartuar duke u bazuar në disa supozime. Siç u përmend më lart, jemi përpjekur t’i identifikojmë këto në mënyrë të qartë në tekst. Kjo është së pari si pranim i faktit se mund të ketë



këndvështrime të tjera dhe së dyti për të siguruar që jeni të vetëdijshëm se këto janë konkluzione për të cilat ju duhet të jeni të lumtur t'i keni pran vetës në qoftë se do të mbështeteni në to në gjykatë.

Manuali gjithashtu është hartuar duke pas në mendje juristët nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Manuali nuk mund domosdoshmërishtë të adresojë të gjitha variacionet individuale në procedurën penale në shtetet e ndryshme anëtare të BE-së (megjithëse përdor shembuj të herëpashershëm nga niveli kombëtar për të vënë çështjet në kontekst). Përveç kësaj, ajo nuk mund të marrë parasysh traditat ekzistuese profesionale dhe rregullat deontologjike (etike) të krijuara nga shoqata kombëtare ose rajonale të avokatëve. Prandaj, ju do të duhet të përshtatni sugjerimet tona për të funksionuar në kontekstin tuaj lokal.

#### e. Mbani kontaktet

Me këto kualifikime, ne ju inkurajojmë që të ndiqni hapat e paraqitur në këtë Manual, provoni argumentet që ne propozojmë dhe na tregoni se si po ecën, duke na kontaktuar përmes informatave kontaktuese të dhëna në parathënie. Ne presim se do të ketë një proces të të mësuarit në vitin e parë ose në dy vitet e para pas afatit të zbatimit të Direktivave dhe do të dëshironim të dëgjonim nga ju për përvojat e juaja dhe të shkëmbejmë mësimet e nxjerra.

### B. PARA DIREKTIVËS: RISHIKIMI I PARIMEVE TË KEDNJ

Direktiva është e bazuar në një fushë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që nuk është shumë voluminoze, por nga e cila megjithatë dalin disa parime kyçe. Praktika gjyqësore për të drejtën për interpretim (dhe për përkthim, deri në një masë) kryesisht paraqitet në kuadër të Nenit 6(3)(a) dhe (e), i cili parasheh që:

*‘Çdokush që akuzohet për një vepër penale ka të drejtat minimale si më poshtë:  
(a) të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe arsyen e akuzës kundër tij;  
...  
(e) të ketë asistencën e një interpreti pa pagesë, nëse nuk e kupton apo flet gjuhën e cila përdoret në gjykatë.’*

Për interpretimin e këtyre dispozitave, GJEDNJ ka zhvilluar ‘deklaratën bazë’ në vijim, e përsëritur kohët e fundit në rastin *Hacioglu v. Romania*:<sup>10</sup>

*‘88. Gjykata përsëritë se paragrafi 3 (e) i Nenit 6 parasheh që çdo i pandehur ka të drejtë të ketë qasje në asistencën e një interpreti pa pagesë. Kjo e drejtë vlen jo vetëm për deklaratat me gojë që bëhen në seancën gjyqësore por edhe por edhe për materialet me shkrim dhe procedurat paragjyqësore. Kjo do të thotë që një i akuzuar që nuk e kupton ose flet gjuhën që përdoret në gjykatë ka të drejtë të ketë ndihmën pa pagesë të një interpreti për përkthimin dhe interpretimin e të gjitha dokumenteve ose deklaratave në procedurat e ngritura kundër tij, të cilat është me rëndësi për të që t’i kuptojë ose t’i kthejë në gjuhën e gjykatës në mënyrë që të përfitojë nga një gjykim i drejtë [...] Dispozita në fjalë nuk shkon aq larg sa të kërkojë përkthim me shkrim të të gjitha pikave të dëshmisë me shkrim ose të dokumenteve zyrtare të procedurës. Në lidhje me këtë duhet të përmendet se teksti i dispozitave përkatëse i referohet një*

<sup>10</sup> Rasti [Hacioglu v. Romania](#), App. no. 2573/03 (Gjykimi i 11 janarit 2011).

*“interpreti”, jo një “përkthyesi”. Kjo sugjeron se asistenca gjuhësore me gojë mund të plotësojë kërkesat e Konventës [...] Megjithatë, mbetet fakti që asistenca e ofruar në interpretim duhet të jetë e tillë që t’i mundësojë të pandehurit të ketë njohuri për rastin kundër tij dhe të mbrojë veten, veçanërisht duke qenë në gjendje të paraqesë para gjykatës versionin e tij të ngjarjeve [...] Duke pasur parasysh nevojën që kjo e drejtë të jetë praktike dhe efektive, detyrimi i autoritetit kompetent nuk kufizohet në emërimin e një interpreti por, në rast se njoftohen në rrethana të caktuara, gjithashtu mund të zgjerohen deri në një masë të kontrollit të saktësisë së interpretimit të ofruar.’<sup>11</sup>*

Një shtesë e rëndësishme në këtë praktikë gjyqësore u bë në vitin 2010, kur në rastin *Diallo v. Suedisë*<sup>12</sup> Seksioni i Tretë i GJEDNJ tërhoqi një paralele në mes të drejtës për të pasur një avokat në stacionin policor dhe të drejtës për të pasur një interpret për ata që nuk flasin gjuhën e procedurave penale, e cila thotë se:

*‘Në të njëjtën linjë të arsytimit, asistenca e një interpreti duhet të ofrohet gjatë fazës së hetimit, përveç nëse dëshmohet në kuadër të rrethanave të veçanta të secilit rast veç e veç se ka arsye bindëse për kufizimin e kësaj të drejte’<sup>13</sup>*

Kjo përcaktoi se, sipas KEDNJ-së, e drejta për të pasur një interpret në stacionin policor është garanci bazë e procedurës penale, e ngjashme me ndihmën e një avokati. Kjo e drejtë, dhe shumë prej koncepteve të evokuara në deklaratën bazë, tani janë pasqyruar në dispozitat kryesore të Direktivës.

---

<sup>11</sup> Paragrafi 88.

<sup>12</sup> Rasti [Diallo v. Sweden](#), App. no. 13205/07 (Gjykimi i 5 janarit 2010).

<sup>13</sup> Paragrafët. 24-25.

## C. PASQYRA E DIREKTIVËS

### 1. Vështrim

Dispozita	Çfarë mbulon	Aspekte të veçanta
Neni 1	Lënda/ fushëveprimi	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zbatohet në procedura penale dhe në procedura për ekzekutimin e një Urdhërarresti Evropian (EAW)</li><li>• Zbatohet nga koha kur personi “njoftohet nga autoritetet kompetente... me njoftim zyrtar ose në ndonjë mënyrë tjetër, se dyshohet ose akuzohet për kryerjen e një vepre penale e deri në përfundimin e procedurës”</li><li>• Në rastet kur kundërvajtjet sanksionohen administrativisht dhe vetëm ankimi bëhet para një gjykate, Direktiva zbatohet vetëm për gjykatën.</li><li>• Nuk prekë ligjet që kanë të bëjnë me qasjen në avokat apo qasjen në dokumente</li></ul>
Neni 2	E drejta për interpretim	<ul style="list-style-type: none"><li>• Subjektet e dyshuara apo personat e akuzuar “të cilët nuk flasin ose nuk kuptojnë gjuhën”, për përkthim të menjëhershëm para autoriteteve gjyqësore dhe gjatë marrjes në pyetje në polici,</li><li>• Interpretimi me qëllim të komunikimit ndërmjet personave të dyshuar apo të akuzuar dhe avokatit ligjor në lidhje të drejtpërdrejtë me çdo pyetje, dëgjim ose ankesë, aty ku është e nevojshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurës</li><li>• Asistencë e duhur për persona me pengesa në dëgjim apo në të folur</li><li>• “Procedura ose mekanizëm” për të vlerësuar nëse nevojitet interpretim</li><li>• E drejta për të kundërshtuar një vendim që konstaton se nuk ka nevojë për interpretim/ mundësia për t’u ankuar për cilësinë e interpretimit të ofruar</li><li>• Përdorimi i teknologjisë së lejuar</li></ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpretimi në procedurat për ekzekutimin e një EAW</li> <li>• Interpretimi duhet të jetë 'i një cilësie që është e mjaftueshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave'</li> </ul>
Neni 3	E drejta për përkthim të dokumenteve e esenciale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• E drejta e personave që nuk flasin ose kuptojnë gjuhën e procedurave penale për "përkthim me shkrim të të gjitha dokumenteve që janë esenciale për të siguruar që ata janë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbrojtje dhe për të mbrojtur drejtësinë e procedurave'.</li> <li>• Dokumentet esenciale përfshijnë: vendimin që privon personin nga liria, çdo akuzë/aktakuzë, çdo gjykim.</li> <li>• Autoritetet kompetente vendosin, në raste të caktuara, nëse edhe ndonjë dokument tjetër është esencial. Personi i dyshuar ose i akuzuar ose avokati i tij ka mundësi të paraqesë kërkesë të arsyetuar.</li> <li>• Nuk pranohen kërkesa për përkthim të fragmenteve të dokumenteve esenciale të cilat nuk janë relevante për të shtuar njohuritë e të dyshuarit ose të akuzuarit për rastin kundër tyre.</li> <li>• E drejta për të kundërshtuar një vendim që përcakton se nuk ka nevojë për përkthim të dokumenteve/ mundësia për t'u ankuar se cilësia e përkthimit nuk është e mjaftueshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave.</li> <li>• Mundësia e ofrimit të 'përkthimit me gojë ose përmbledhje me gojë' në vend të përkthimit me shkrim.</li> <li>• Heqja dorë vetëm në kushtet të këshillimit paraprak ligjor/ përndryshe informim i plotë për pasojat e heqjes dorë, e cila duhet të jetë e qartë dhe e dhënë vullnetarisht.</li> </ul>
Neni 4	Kostot	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare bartin të gjitha shpenzimet e interpretimit, pavarësisht rezultatit të procedurave</li> </ul>
Neni 5	Cilësia	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet Anëtare ndërmarrin "masa konkrete" për të siguruar që interpretimi/përkthimi përmbushë standardet e kërkuara</li> <li>• Shtetet anëtare "përpiqen" të krijojnë (një) listë(a) të interpretëve/përkthyesve të kualifikuar të pavarur.</li> <li>• Obligimi i sigurimit të interpretëve/përkthyesve kërkon respektimin e konfidencialitetit</li> </ul>
Neni 6	Trajnimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkesa për trajnim të "gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit gjyqësor" për punën me interpret</li> </ul>

Neni 7	Mbajtja e shënimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Detyrimi për të regjistruar ofrimin e interpretimit gjatë marrjes në pyetje ose seanceve dëgjimore, kur ofrohet përkthim oral/përmbledhje, ose kur hiqet dorë nga përkthimi</li> </ul>
Neni 8	Mos -regresi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Direktiva nuk kufizon masat mbrojtëse që rezultojnë nga e drejta ndërkombëtare apo kombëtare e cila ofron nivel më të lartë të mbrojtjes.</li> </ul>

## 2. Qëllimi dhe objektivat

Siç është shpjeguar më poshtë, Direktiva është bazuar mbi standardet tashmë të krijuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo gjë është pasqyruar në deklaratat e Direktivës. Deklaratat në vete nuk përbëjnë obligime, por përmbajnë informata të rëndësishme në lidhje me historikun e një instrumenti legjislativ dhe ofrojnë udhëzime për interpretimin e tij. Në rastin e Direktivës, duket se qëllimi kryesorë i saj është të shndërrojë standardet ekzistuese të KEDNJ-së në ligje të qarta.

‘(14) E drejta për interpretim dhe përkthim për ata që nuk flasin ose nuk e kuptojnë gjuhën e procedurave parashihet në Nenin 6 të KEDNJ-së, siç është interpretuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo Direktivë ndihmon zbatimin e asaj të drejte në praktikë. Në këtë kontekst, qëllimi i kësaj Direktive është të sigurojë të drejtën për interpretim dhe përkthim të personave të dyshuar ose të akuzuar në procedurat penale duke synuar në sigurimin e të drejtës për gjykim të drejtë.’

‘(33) Dispozitat e kësaj Direktive që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ ose nga Karta duhet të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë konsistente me ato të drejta, siç janë interpretuar në praktikën gjyqësore relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (...).’

Këto deklarata e bëjnë të qartë se Direktiva synon të ndihmojë në zbatimin e të drejtave të cilat tanimë ekzistojnë në KEDNJ. Kjo do të thotë se, kur bëni arsyetime ligjore, mundeni, nëse dëshironi, t’i referoheni praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që të sugjeroni se si duhet të interpretohen dispozitat të caktuara të Direktivës. Për këtë arsye, aty ku e kemi parë të dobishme, në këtë Manual kemi futur referenca të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (në veçanti në lidhje me konceptin e “ushtrimit të kontrollit me rastin e njoftimit”). Megjithatë, siç u përmend më lartë, në krahasim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Direktiva është më e qartë dhe mund të ofrojë mbrojtje më të mirë se GJEDNJ-ja, prandaj ju inkurajojmë që si rregull argumentet e juaja t’i bazoni në Direktivë. Në të vërtetë, deklaratat paraqesin një gjuhë të re të ‘BE-së’:

‘(17) Kjo direktivë duhet të sigurojë se ka asistencë gjuhësore pa pagesë dhe adekuate, që iu mundëson personave të dyshuar ose të akuzuar të cilët nuk e flasin apo kuptojnë gjuhën e procedurave penale, të ushtrojnë plotësisht të drejtën e tyre për mbrojtje dhe për ruajtje të drejtësisë së procedurave.’

‘(22) Interpretimi dhe përkthimi sipas kësaj Direktive duhet të ofrohet në gjuhën amtare të personit të dyshuar apo të akuzuar apo në ndonjë gjuhë tjetër që ata e flasin ose e kuptojnë për të iu mundësuar atyre ushtrim të plotë të të drejtës së tyre për mbrojtje, dhe për ruajtje të drejtësinë së procedurave.’

Këto koncepte që i mundësojnë të dyshuarit apo të akuzuarit të “ushtrojnë plotësisht të drejtën e

tyre për mbrojtje” dhe “për të ruajtur drejtësinë e procedurave” rishfaqen përgjatë tërë Direktivës dhe masave të tjera të miratuara në kuadër të Udhërrëfyesit. Domethënia e tyre është e papërcaktuar dhe e hapur për interpretim.

### 3. E drejta për interpretim dhe përkthim

Neni 1 përcakton atë që duket të jetë një e drejtë e përgjithshme për interpretim dhe përkthim që është e zbatueshme përgjatë procedurave penale:

#### Neni 1 – lënda dhe fushëveprimi

1. Kjo direktivë përcakton rregullat në lidhje me të drejtën për interpretim dhe përkthim në procedurat penale(...).
2. E drejta e përmendur në paragrafin 1 zbatohet për personat nga momenti kur ata njoftohen nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar, me anë të një njoftimi zyrtarë apo ndryshe, se dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një veprë penale e deri në përfundimin e procedurës [...]

Do t'i referohemi përsëri Manualit “Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikë” dhe të sugjerojmë se kjo dispozitë siguron dëshmi fillestare se ajo që synohet nga Direktivat është t'u jepen individëve “të drejta” të veçanta të cilat mund të thirren në nivel kombëtar. Gjithashtu sugjerojmë t'i referoheni Pjesës IV të Manualit për Direktivën mbi të drejtën për informim, ku kemi mbuluar çështjen që ka të bëjë me zbatimin e asaj Direktive për personat, përveç atyre që zyrtarisht janë njoftuar për statusin e tyre si të dyshuar. Të njëjtat konsiderata zbatohen edhe këtu: nëse një person është objektivisht i dyshuar, ai/ajo gëzon të drejtat që jep Direktiva edhe nëse sipas ligjit kombëtar nuk janë vendosur zyrtarisht nën hetim. Përtej kësaj, ju referojmë në pjesët relevante të këtij Manuali për diskutimin e dispozitave thelbësore të Direktivës

## D. PUNA PËRGATITORE PËR PËRDORIMIN E DIREKTIVËS

Para se të filloni të konsideroni situata praktike në të cilat dëshironi të mbështeteni në Direktivë, është e këshillueshme që të bëni ca punë paraprake për të siguruar se keni marr parasysh materialin e duhur ligjor dhe materiale tjera për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë Direktivë.

### 1. Ekzaminimi i ligjit dhe praktikës kombëtare në dritën e Direktivës

Procesi i interpretimit dhe përkthimit në juridiksionin tuaj mund të jetë i dorës së dytë për ju si avokat praktikues. Megjithatë, është me rëndësi të bëjmë një hap prapa dhe të shqyrtojmë përsëri kornizën legjislative dhe praktike nën dritën e Direktivës. Kohët e fundit mund të jenë bërë ndryshime të reja për zbatimin e Direktivës dhe është e dobishme të shikoni dispozitat përkatëse nga këndvështrimi i kërkesave të Direktivës, pasi kjo do t'ju ndihmojë të krijoni një pamje fillestare të asaj se ku mund të lindin probleme me përputhshmërinë.

Përdorni çdo sistem që është në dispozicion në sistemin kombëtar për identifikimin e dispozitave relevante. Nga këndvështrimi i BE-së ekziston një mënyrë sistematike (por jo e përkryer) për identifikim të legjislacionit relevant përmes bazës së të dhënave “Eur-Lex” e cila ruan ose lidhet me tërë legjislacionin dhe praktikën gjyqësore të BE-së, dhe gjithherë e më shumë edhe me ligjet dhe

praktikat gjyqësore kombëtare. Këtu kemi paraqitur një mënyrë se si mund të përdoret ky sistem për të gjetur legjislacionin që Shteti juaj Anëtar merr në konsideratë për të siguruar përputhshmëri me Direktivën:

- ➔ Identifikimi i legjislacionit relevant kombëtar
- Hyni në <http://eur-lex.europa.eu> dhe përzgjidhni gjuhën tuaj;
  - Në seksionin “search by document reference” (ose ekuivalenti në gjuhën tuaj) shkruani ‘2010’ në fushën ‘Viti’ dhe ‘64’ në fushën ‘Numri’, dhe klikoni në kutinë ‘Direktiva’ (kërkoni Direktivën 2010/64/EU);
  - Kjo do të sjellë një link me titullin e plotë të Direktivës. Klikoni në të;
  - Në ekran do të shihni tekstin e direktivës dhe një tabelë me linqe për disa versione gjuhësore. Mbi këtë gjenden disa skeda, një prej të cilave ka emrin ‘Linked documents’ (ose ekuivalenti në gjuhën tuaj). Klikoni në të;
  - Më poshtë faqes do të shihni një opsion ku shkruan ‘Shfaqini masat zbatuese kombëtare: MZK, link i ligjeve zbatuese të secilit shtet. Klikoni në të;
  - Kaloni nëpër listën e rezultateve derisa të shihni emrin e Shtetit tuaj Anëtar të shfaqet si ‘autor’, me titullin e legjislacionit në fjalë. Rezultatet do të përfshijnë masa të reja zbatuese dhe referenca të ligjeve të vjetra që mbulojnë temat përkatëse. Lëvizni poshtë faqes dhe gjeni shënimet që janë relevante për shtetin tuaj.

Sugjerojmë që ta shqyrtoni legjislacionin tuaj kombëtar, duke pasur parasysh të kuptuarit tuaj për funksionimin në praktikë, për të përcaktuar se si Direktiva aplikohet në juridiksionin tuaj. Pyetjet kryesore, që do t’i sugjeronim ne, janë këto:

➔ Ekzaminimi i ligjit dhe procedurave kombëtare në dritën e Direktivës

**Interpretimi**

- Çfarë mekanizmi ekziston për të vlerësuar nëse një i dyshuar/akuzuar ka nevojë për interpretim dhe çfarë faktorë merren parasysh?
- Cilat janë autoritetet komponentë për kryerjen e këtij vlerësimi në faza të ndryshme të procedurave penale?
- Çfarë e rregullon përzgjedhjen e një interpreti? A ka ndonjë regjistër apo udhëzues zyrtar?
- Nëse një i dyshuar/akuzuar kundërshton vendimin në lidhje me interpretimin, çfarë mekanizma ka në dispozicion për ta sfiduar atë?

**Përkthimi**

- Çfarë dokumente kërkohet të përkthehen?
- A përkthehen dokumentet në tërësi dhe me shkrim, apo bëhet një shpjegim me gojë i dokumenteve apo përkthehen vetëm pjesë të dokumenteve? Çfarë kritere zbatohen?
- Nëse një i dyshuar/akuzuar kundërshton një vendim në lidhje me përkthimin e dokumenteve, çfarë mekanizma ka në dispozicion për ta sfiduar atë?

**Kërkesat për cilësi**

- Çfarë sistemi ka në dispozicion për matjen e cilësisë së interpretimit dhe përkthimit?
- Çfarë sistemi ka në dispozicion për të bërë një ankesë në lidhje me cilësinë?

## 2. Hetimi i kontekstit lokal

### a. Mësoni për standardet kombëtare të interpretimit

Mund të ketë edhe organe profesionale me standarde të përbashkëta, kode të etikës dhe/ose praktika të mira dhe këto mund të ofrojnë një pikë referimi të dobishme që ju që të mbani parasysh kur merreni me situata specifike në stacionin e policisë dhe në gjykata.

- ➔ Mësoni për standardet kombëtare dhe praktikën e mira
- A ka ndonjë organizatë (qeveritare apo tjetër) që përfaqëson interpretët?
- Kontaktoni ato dhe kërkoni kopje të udhëzuesve në lidhje me kualifikimet minimale që kërkohen për interpretim në stacionin e policisë, praktikën më të mira etj.
- Familjarizohuni me të gjitha materialet relevante në mënyrë që të jeni të gatshëm t'i sillni në vëmendjen e personave në stacionin policor nëse është e nevojshme .

### b. Bisedoni me kolegët/odat e avokatëve

Është shumë e mundshme që Direktiva, e ndoshta edhe masat zbatuese kombëtare, nuk do të bëhen menjëherë të ditura për të gjitha palët e interesit. Mirëpo, nëse më shumë avokatë kanë njohuri për masat dhe kërkojnë të bazohen në to, policia dhe gjykatat do të vërejnë argumentimet e njëjta që vazhdojnë të përsëriten. Kjo do ta bëjë këtë çështje më të vështirë që të injorohet si dhe do të shtojë besueshmërinë e argumenteve të bazuara në Direktivë. Ne sugjerojmë:

- ➔ Përhapni fjalën:
- Pyesni Odën e Avokatëve nëse ka informuar anëtarësinë e saj për ligjet e reja.
- Shpërndani këtë manual mes rrjeteve ligjore dhe përmes Odave të Avokatëve.

Diskutimi rreth Direktivave dhe mënyrës së përdorimit të tyre është i ri dhe është pjesë e rëndësishme e strategjisë për zbatim që është hartuar nga LEAP. Në këtë kontekst, anëtari i Bordit Këshillëdhënës të LEAP për Portugalinë, Vania Costa Ramos, ka shkruar për përdorimin e Direktivës në praktikën penale portugeze dhe ne ju inkurajojmë që të lexoni përkthimin në gjuhën angleze që kemi vënë në dispozicion.<sup>14</sup> Nëse keni shkruar diçka që mendoni se do të ndihmonte kolegët në Shtetet e tjera Anëtare, ju lutemi na kontaktoni.

---

<sup>14</sup> Vania Costa Ramos, 'Përdorimi i të drejtës Evropiane në praktikën penale', përkthimin në anglisht nga Fair Trials, mund ta gjeni në <http://www.fairtrials.org/publications/article-the-use-of-european-law-in-criminal-proceedings/>.



# I – VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR INTERPRETIM

## A. PROBLEMI

---

Kurdo që një problem i mundshëm në lidhje me asistencën gjuhësore lind, ai fillon me pyetjen kryesore: a ka nevojë personi i dyshuar apo i akuzuar për një ndihmë të tillë? Diskutimet e “Fair Trials” me praktikues në rrjetin LEAP kanë shpalosur një sërë shqetësimesh që kanë të bëjnë me mënyrën se si kryhen vlerësimet e tilla, veçanërisht në stacione policore kur policia operon nën kufizime kohore. Janë ngritur pikat si më poshtë:

- Mungesa e një sistemi të formalizuar për vlerësimin e nevojave për interpretim, që rezultojnë në aplikimin e mekanizmave joformal, si në raste ku polici bën pyetje të tilla si “a kuptoni Italisht?” dhe vazhdon procedurat mbi këtë bazë;
- Mungesa e një sistemi për identifikimin e gjuhës amtare të personit; dhe
- Mungesa e mekanizmave që sigurojnë disponueshmëri të interpretimit për konsultimet avokat/klient, veçanërisht kur klienti është mbajtur në një qeli në polici.

Problemi është mungesa e sistemeve adekuate për vlerësimin dhe reagim ndaj nevojës së saktë të interpretimit: çfarë gjuhe flet në fakt personi? A e kupton bashkëbiseduesin në kontekstin specifik? a e kupton ai gjuhën e procedurës deri në masën që kërkohet në kontekstin e caktuar (p.sh. në mënyrë që të jetë në gjendje t'i përgjigjet pyetjeve të detajuara faktike)? Kjo është tema e këtij seksioni.

## B. BAZA E KEDNJ

---

Praktika gjyqësore është e kufizuar sa i përket kësaj çështjeje, megjithatë GJEDNJ ka bërë disa deklarata që në vija të trasha ofrojnë udhëzime se si duhet të kryhet një vlerësim i tillë:

### 1. Supozim në favor të interpretimit nëse kërkohet

Në rastin *Brozicek v. Italy*,<sup>15</sup> GJEDNJ shqyrtoi nëse dështimi për ofrim të asistencës gjuhësore kur është kërkuar ka përbërë shkelje të Nenit 6(3)(e). Pas konkludimit se është bërë shkelje, GJEDNJ deklaroi:

**‘41. (...)Me pranimin e kësaj kërkesë, autoritetet gjyqësore Italiane është dashur të ndërmarrin hapat e nevojshëm që të përmbushin atë në mënyrë që të sigurohet respektimi i kërkesave të [Neni 6(3)(a)], përveç nëse kanë qenë në gjendje të vërtetonin se aplikanti në fakt kishte njohuri të mjaftueshme të gjuhës Italiane (...) (theksi i shtuar).<sup>16</sup>**

Fair Trials konsideron se ky rast e vendos një prezumim (mjaft të natyrshëm) në favor të interpretimit, i cili duhet të kundërshtohet nga autoritetet e shtetit. Megjithatë, pasi personi mund të mos jetë i vetëdijshëm për të drejtën e tij/saj për interpretim dhe përkthim, kërkesa është vetëm pika fillestare. Më tej, praktika gjyqësore përshkruan faktorët që normalisht do të jenë relevante me

---

<sup>15</sup> *Brozicek v. Italy*, App. no. 10964/84 (Gjykim i 19 dhjetorit 1989).

<sup>16</sup> Paragrafi. 41.

qëllim të vlerësimit të nevojave për interpretim.

## 2. Parametrat për vlerësimin e nevojave për interpretim

Gjithashtu, GJEDNJ ka bërë disa deklarata të dobishme në rastet kur pohohet se dështimi për sigurim të interpretimit ka shkelur Nenin 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me rastin *Hermi v. Italy*,<sup>17</sup> GJEDNJ ka deklaruar:

' (...) çështja e njohurive gjuhësore të të pandehurit është vitale dhe [Gjykata] duhet gjithashtu të ekzaminojë natyrën e veprës për të cilën akuzohet i pandehuri dhe çdo komunikim që i adresohet atij nga autoritetet vendore, për të vlerësuar nëse janë aq komplekse sa që kërkojnë njohuri të detajuar të gjuhës që përdoret në gjykatë'<sup>18</sup> (theksimi i shtuar).

Një gjë mund të nxirret nga kjo deklaratë: se çështja nëse dikush ka nevojë për asistencë gjuhësore vlerësohet duke marr parasysh aftësitë specifike gjuhësore të personit në fushën specifike të lëndës. Faktorët që paraqiten në praktikën gjyqësore janë këto:

- Personi nuk e ka si gjuhë amtare gjuhën që përdoret në procedurë;<sup>19</sup>
- Dallimi ndërmjet të qenit në gjendje të shprehur dhe të qenit në gjendje të lexojë dokumente, nëse kërkohet një gjë e tillë;<sup>20</sup>
- Gjendja financiare, sociale dhe kulturore e personit, përfshirë kohëzgjatjen e qëndrimit në shtet;<sup>21</sup> dhe
- Personi është analfabet.<sup>22</sup>

Gjithashtu duhet të theksohet se ekziston një fokus i veçantë në rëndësinë e kësaj analize në fazën e hetimeve. Siç u përmend më lartë, GJEDNJ-ja ka përcaktuar të drejtën e interpretimit si të ngjashme me të drejtën e qasjes në avokat si një mbrojtje e rëndësishme në fazat e hershme të procedurës penale. Kjo ka bërë që GJEDNJ-ja t'i kushtojë vëmendje të veçantë aftësive gjuhësore në këtë fazë:

"Duke marr parasysh rëndësinë e fazës së hetimeve siç u përmend më lartë, Gjykata nuk është e bindur se aplikanti i kuptonte mjaftueshëm pyetjet që i parashtrheshin dhe se ajo nuk ishte në gjendje të shprehej në mënyrë adekuate në gjuhën turke, dhe sigurisht jo në atë nivel sa të mund të përdorej deklarata e saj si dëshmi kundër saj në gjykim (...) Pa ndihmën e një interpreti, ajo nuk mund të ketë kuptuar pasojat që mund të ketë pranimiti i saj që të merret në pyetje pa ndihmën e një avokati në një çështje penale që lidhet me hetimin e veprave penale të rënda"<sup>23</sup>

GJEDNJ-ja është padyshim e vëmendshme që procesi gjatë fazës fillestare ka ndikim të madh në procesin e mbrojtjes dhe se mossaigurimi i interpretimit rrezikon që të ndikojnë në mënyrën se si i dyshuari merr vendime në një kontekst kur deklaratat e tij mund të përdoren në procedurë. Është

<sup>17</sup> Rasti *Hermi v. Italy*, App. no. 18114/02 (Gjykimi i 18 tetorit 2006)

<sup>18</sup> Paragrafi. 71

<sup>19</sup> Rasti *Amer v. Turkey*, App. no. 25720/02 (Gjykimi i 13 janarit 2009), para. 82.

<sup>20</sup> Ibid.

<sup>21</sup> Rasti *Katritsch v. France* App. no. 22575/08 (Gjykimi i 4 nëntorit 2011), para. 45.

<sup>22</sup> Rasti *Şaman v. Turkey*, App No 35292/05 (Gjykimi i 5 prillit 2011), paragrafi 31

<sup>23</sup> Paragrafët. 31 dhe 35

tejet e rëndësishme të bëhet një vlerësim i kujdesshëm nëse ata kanë nevojë për interpretim në atë fazë.

### C. DISPOZITA TË RËNDËSISHME TË DIREKTIVËS

Vlerësimi i nevojave të përkthimit është i lidhur me pjesën *ratione personae* të Direktivës, d.m.th. ata persona që kanë të drejtë të kenë qasje në interpretim sipas kërkesave të kësaj Direktive. Neni 2(1), duke përcaktuar të drejtën për interpretim në procedura penale thotë:

'1. Shtetet Anëtare sigurojnë se **personave të dyshuar ose të akuzuar të cilët nuk flasin ose nuk kuptojnë gjuhën e procedurave penale** në fjalë, pa vonesë, iu ofrohet interpretim gjatë procedurave penale para autoriteteve hetuese dhe gjyqësore, përfshirë gjatë marrjes në pyetje në polici, gjatë të gjitha seancave dëgjimore dhe në çdo seancë dëgjimore të ndërmjetme' (theksimi është shtuar).

Direktiva vazhdon në Nenin 2(4) dhe (5):

'4. Shtetet Anëtare sigurojnë se ekziston një procedurë ose një mekanizëm për të vlerësuar nëse personi i dyshuar ose i akuzuar flet dhe kupton gjuhën e procedurave penale dhe nëse kanë nevojë për ndihmën e një interpreti.'

5. Shtetet Anëtare sigurojnë se, në përputhje me procedurat në ligjin kombëtar, personat e dyshuar ose të akuzuar kanë të drejtë të kundërshtojnë një vendim që thotë se nuk ka nevojë për interpretim (...).'

Deklaratat po ashtu ofrojnë disa udhëzime:

'(21) (...) Një procedurë ose mekanizëm i tillë nënkupton që autoritetet kompetente verifikojnë në çfarëdo mënyre që është e përshtatshme, përfshirë konsultimin me personin e dyshuar ose të akuzuar në fjalë, nëse ai/ajo flet dhe kupton gjuhën e procedurave penale dhe nëse kanë nevojë për ndihmën e një interpreti.'

Do t'i diskutojmë këto dispozita më hollësisht më poshtë kur të flasim për atë se si të bazohemi në të njëjtat. Megjithatë, në këtë pikë do të sqarojmë se cilat mendojmë se janë disa prej supozimeve bazë:

- Direktiva jep të drejtën për interpretim njerëzve që nuk flasin apo kuptojnë gjuhën e procedurave penale. Çështja se nëse një person e përmbushë këtë përcaktim duhet domosdo të bazohet në faktorë objektiv të cilët dallojnë nga rasti në rast.
- Kjo konfirmohet nga detyrimi në Nenin 2(4) për posedimin e një mekanizmi për identifikimin e personave të tillë, referenca në Deklamimin 21 për konsultimin e personit të dyshuar ose të akuzuar, që duhet patjetër të bëhet për secilin rast veç e veç, dhe nga ekzistenca e të drejtës për të kundërshtuar sipas Nenit 2(5) që nënkupton vendim individual.
- Megjithatë, nuk ka udhëzime se çfarë, praktikisht, duhet të rregullojë vlerësimin e kërkuar. Për aq sa kjo Direktivë në tërësi synon të lehtësojë zbatimin e të drejtave që dalin nga KEDNJ, dhe që mbrohen nga karta, faktorët e identifikuar nga GJEDNJ të përmendur më lartë janë padyshim të rëndësishëm. Megjithatë, është përgjegjësi e GjDBE-së të ofrojë udhëzime të mëtejme.

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

Adresimi i problemit duhet të fillojë me një qasje parandaluese, duke kërkuar mbështetje në Direktivë për të siguruar që të mos ndodhin shkelje. Duke e kundërshtuar shkeljen e supozuara në faza të hershme, do të krijoni një evidencë që mund të përdoret më vonë në procedura.

### 1. Sqarimi i pozicionit në stacionin e policisë (nëse jeni aty)

“Fair Trials” sugjeron se, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, disa gjëra duhet të bëhen të qarta që në momentin kur fizikisht gjendeni në pikën kur merret vendimi i parë:

→ Shpjegoni pse nevojitet interpretimi:

- Siguroni që policët informohen në mënyrë të qartë për nevojën për interpretim.
- Tregoni autoritetit se janë të obliguar që të justifikojnë vendimin e tyre për të mos ofruar interpretim, kërkonin nga ata t'i numërojnë arsyet e tyre për konstatimin se personi flet dhe kupton gjuhën dhe regjistrojeni të njëjtën me shkrim.
- Nëse klienti mund të flasë gjuhën deri në njëfarë mase, diskutoni pak rastin me të për të kontrolluar nëse është në rregull sa i përket terminologjisë së caktuar, duke mbajtur shënime për çështjet që shkaktojnë vështirësi.
- Megjithatë, në çfarëdo rasti, nuk duhet të pranoni vendimin për të mos siguruar interpretim nëse një gjë e tillë është kërkuar. Duhet ta kundërshtoni këtë vendim.

### 2. Kundërshtimi i vendimit që thotë se nuk ka nevojë për interpretim

Nëse vendimi fillestar në stacionin e policisë është që të vazhdohet pa interpret, ju sigurisht që duhet të protestoni nëse mendoni se në fakt ka nevojë për interpret. Kjo do të përfshinte refuzimin për të vazhduar me marrjen në pyetje derisa çështja të referohet tek një autoritet më i lartë, nëse ka një të tillë.

→ Refuzohet sigurimi i interpretimit: çfarë duhet bërë?

- Ankohuni tek një autoritet më i lartë, nëse ka të tillë.
- A ka ndonjë zyrtar më të lartë policorë/prokurorë ku mund të adresohet çështja?
- Përcaktoni bazën e kundërshtimit tuaj dhe regjistroni atë/ siguroni që është regjistruar nga autoritetet në formë të shkruar.

Çfarë nëse nuk ekziston ndonjë sistem i caktuar për të kundërshtuar vendimin e policisë? Kjo nuk është domosdoshmërishtë në kundërshtim me Direktivën: mos harroni se Deklamimi 25 ("Ajo e drejtë nuk nënkupton detyrim për Shtetet Anëtare që të sigurojnë një mekanizëm të veçantë ose procedurë ankimore përmes të cilës mund të kundërshtohet një vendim i tillë"). Megjithatë, në këtë rast, duhet të ketë mbrojtje diku tjetër.

Në këtë aspekt, është mirë që të merret parasysh vendimi e GjDBE-së në rastin Samba Diouf. Një aplikacion për azil ishte proceduar sipas procedurës të përshpejtuar, siç edhe është e lejuar me direktivën përkatëse. Vendimi për ta trajtuar rastin me procedurë të përshpejtuar, si i tillë nuk ishte subjekt i kundërshtimit, por vendimi mbi meritat po. Gjykata vendosi se parimi i përgjithshëm i mbrojtjes gjyqësore efektive nuk kërkon kundërshtim të veçantë të vendimit për përshpejtim,

me kusht që arsyet të cilat kanë shtyrë autoritetin të ekzaminojë meritat e aplikimit sipas një

procedure të tillë, në fakt mund t'i nënshtrohen rishikimit gjyqësor në veprimin i cili mund të ngrihet kundër vendimit përfundimtar për refuzim të aplikacionit.<sup>24</sup>

Shkurtimisht, nëse rishikimi gjyqësor i vendimeve procedurale preliminare nuk ekziston si i pavarur, ai sigurohet në kontekstin e rishikimit gjyqësor të vendimit final. Kjo aludon në llojin e përgjigjes të cilën mund të jeni duke e kërkuar këtu: nëse nuk ka ndonjë “kundërshtim” specifik në dispozicion, duhet të gjeni mbrojtje gjyqësore gjetiu, veçanërisht duke u mbështetur në procedurat penale të gjykatës për të siguruar efektivitet të së drejtës për interpretim që sigurohet nga Direktiva, dhe për të “mbrojtur drejtësinë e procedurave” siç kërkohet nga Direktiva; në këndvështrimin e Fair Trials, kjo përfshinë mundësinë për të shqyrtuar arsyet e një vendimi për mos sigurim të interpretimit dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura korrektuese nëse i njëjti nuk ka qenë në përputhje me Direktivën. Për të përmbledhur:

→ Nuk ekziston një mekanizëm i veçantë ankimi: çfarë duhet bërë?

- Siguroni që është regjistruar momenti kur është marr vendimi, përfshirë bazën mbi të cilën është marrë ai vendimi që thotë se nuk ka nevojë për interpretim; nëse ky detaj nuk është regjistruar në procesverbalin/protokollin e procedurave;
- Përdoreni këtë fakt më vonë kur bëni paraqitjen e argumenteve para gjykatës, në kontekst të çdo seance paraprake, gjatë diskutimeve mbi pranueshmërinë e provave, ose në diskutime për atë se a mund të merren parasysh apo a mund të konsiderohen me peshë dëshmitë në fjalë.
- Argumentoni: parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore nënkupton që gjykata që merr vendim mbi procedurën penale duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë arsyet në bazë të të cilave është vendosur që të mos ofrohet interpretimi, dhe të ndërmarrë veprime korrigjuese për të siguruar drejtësinë e procedurave nëse vendimi nuk ka qenë në përputhje me Direktivën (shih, me analogji, vendimin Samba Diouf). Në thelb, ekziston supozimi se interpretimi nevojitet nëse kërkohet (shih vendimin e GjEDNj-së në rastin Brozicek v. Italy) dhe duhet t'i kushtohet kujdes aftësisë së të pandehurit që të flas dhe kuptoj gjuhën në nivelin që kërkohet sipas specifikave të rastit. Vendimi i policisë për të mos ofruar përkthim nuk demonstronte se i dyshuari mund të fliste gjuhën sipas këtij kriteri dhe për këtë arsye nuk ishte në përputhje me Direktivën. Gjykata, në përputhje e rrethanat, duhet të sigurojë efektivitetin e Direktivës duke siguruar që vendimi i saj të mos kontaminohet nga kjo shkelje e Direktivës. Gjykata duhet të përdorë mjetet që ka në dispozicion siç është lëshimi i një urdhri për të përsëritur veprimet e para gjykimit të cilat janë kryer pa praninë e interpretit ose t'i shpallë ato të pavlefshme, të refuzojë të bazohet në rezultatet e tyre etj.

<sup>24</sup> Rasti C-69/10 *Samba Diouf* ECLI:EU:C:2011:524, paragrafi 56.

## PJESA II – CILËSIA E INTERPRETIMIT NË STACIONIN POLICOR

### A. PROBLEMI

---

Ajo që ndodhë në stacionin policor është esenciale për procedurat penale. Siç është deklaruar GJEDNJ në rastin *Salduz v. Turkey*, “faza e hetimit ka rëndësi të veçantë për përgatitjen e procedurave penale, pasi që faktet që mblidhen gjatë kësaj faze përcaktojnë kornizat brenda të cilave do të shqyrtohet vepra e kryer”.<sup>25</sup> Në veçanti, vendimet do të merren nga i dyshuari për mbrojtjen e tij, dhe deklaratat që i bën në këtë kontekst mund të përdoren si bazë për hetime të mëtejme dhe/ose për dënim të mëvonshëm.

Nëse i dyshuari duhet të komunikojë përmes interpretimit, dhe interpretimi nuk mundëson komunikim efektiv, lind rreziku i padrejtësisë. I dyshuari mund të keqkuptojë pyetjet, dhe të përgjigjet gabimisht. Përgjigjet e tij mund të keqinterpretohen. Mund të bëhen deklaratat që mund të duken inkriminuese për shkak të interpretimit të keq, dhe si rezultat mund të lindin mospërputhje faktike në deklaratat e mëvonshme, duke dëmtuar kështu besueshmërinë e personit dhe perspektivën e mbrojtjes.

Në kontekst të takimeve me ekspertë të drejtësisë penale nga rrejtji LEAP, pjesëmarrësit përshkruan një sërë problemesh të përsëritura në lidhje me interpretimin në stacionin policor. Për shembull, na është thënë se në disa shtete:

- Nuk ka kërkesa për certifikim ose kualifikim të veçantë për të bërë punën e interpretit, duke rezultuar që interpretët të zgjedhën në bazë të rrjedhshmërisë që kanë në gjuhën përkatëse dhe shpesh iu mungon trajnimi;
- Pavarësia e interpretëve shpeshherë është diskutabile, duke u nisur nga fakti që ata kanë marrëdhënie komerciale me policinë, të cilët shpesh angazhojnë interpretët e njëjtë. Kësaj i kontribuon edhe mos zbatimi i kodeve të etikës;
- Ka dyshime për cilësinë e interpretimit, veçanërisht kur përdoren terme specifike teknike ose ligjore, ose kur përfshihen gjuhë dhe dialekte të minoriteteve;
- Avokatët zakonisht nuk janë në gjendje të identifikojnë probleme që lidhen me interpretimin, përveç nëse ndodhë që avokati të flasë gjuhën në fjalë;
- Dihet që interpretimi ligjor kërkon shkathtësi të veçanta dhe, veçanërisht me shkurtime buxhetore në drejtësi, interpretët në stacionet policore/ gjykata nuk i posedojnë të gjithë këto shkathtësi.

---

<sup>25</sup> Rasti *Salduz v. Turkey*, App. no. 36391/02 (Gjykimi i 27 nëntorit 2008), paragrafët 54-55.

## B. BAZA E KEDNJ

Siç u përmend më lartë, GJEDNJ duke filluar nga vendimi i pranueshmërisë në rastin Diallo v. Suedisë, ka bërë lidhjen e nevojës për interpretim në fazën fillestare të procedurave penale me të drejtën e qasjes në avokat. Kohët e fundit ajo ka deklaruar se:

*Personi i arrestuar ka një sërë të drejtash, siç janë e drejta për të mos folur apo për të pasur ndihmën e një avokati. Vendimi për të shfrytëzuar apo për të hequr dorë nga këto të drejta mund të merret vetëm nëse personi të cilit i takojnë këto të drejta i kupton qartë faktet që mbahen kundër tij në mënyrë që t'i vlerësojë pasojat potenciale të procedurave dhe të shqyrtojë me urtësi heqjen dorë nga këto të drejta.<sup>26</sup>*

Megjithëse, GJEDNJ këtu më shumë synon situatën ku interpretimi nuk i është siguruar një individ që ka nivel të kufizuar të të kuptuarit të gjuhës së forumit (si në rastin në fjalë), një gjë e tillë zbatohet në mënyrë të barabartë edhe kur interpretimi është i një cilësie të dobët, pasi që kjo gjë ngjashëm mund të shkaktojë keqkuptime.

Megjithatë, më e rëndësishme është qasja e GJEDNJ-së në lidhje me përshtatshmërinë e interpretimit të ofruar. Deklarata kryesore e paraqitur më poshtë është gjetur në të gjitha rastet relevante:

*'Ndhimja e ofruar në interpretim duhet të jetë e tillë që ta bëjë të mundur që i pandehuri të ketë njohuri për rastin kundër tij dhe ta mbrojë veten, veçanërisht duke qenë në gjendje që ta prezantojë para gjykatës versionin e tij të ngjarjes'.<sup>27</sup>*

Në këtë mënyrë GJEDNJ lidhë saktësinë e interpretimit me ushtrimin e të drejtave tjera, në veçanti atë të të qenit të informuar për rastin (Neni 6(3)(a)) dhe të qenit në gjendje për t'u mbrojtur (Neni 6(3)(b)). Më tej praktika gjyqësore përcakton se autoritetet kërkohet të reagojnë në rast se ka shenja që tregojnë se ky standard nuk është plotësuar:

*'Duke pasur parasysh nevojën që e drejta e garantuar nga [Neni 6(3)(e)] të jetë praktike dhe efektive, detyrimi i autoriteteve kompetente nuk kufizohet me emërimin e një interpreti por, nëse vihen në dijeni në rrethana të caktuara, mund të bëjnë edhe kontrolle pasuese sa i përket përshtatshmërisë së interpretimit të ofruar' (paragrafi 74).<sup>28</sup>*

Shembujt të asaj se çfarë përbën ushtrim të "kontrollit" kur "vihen në dijeni" përfshijnë një gamë të vogël të praktikës gjyqësore, por ekzistojnë dy shembuj:

- Shkelja e Nenit 6(3)(e) për shkak të mos sigurimit të interpretimit adekuat kur është ditur se i pandehuri në një seancë dëgjimore kishte vështirësi në komunikim, dhe gjykata është mbështetur në 'shkathtësitë gjuhësore të

<sup>26</sup> Rasti *Baytar v. Turkey* App. no 45440/04 (Gjykimi i 14 tetorit 2014), para. 53 (përkthim i lirë).

<sup>27</sup> *Kamasinski v. Austria* App. no 9783/82 (Gjykimi i 19 dhjetorit 1989) paragrafi 74

<sup>28</sup> Ibid

*patestuara' të një anëtari të familjes i cili ndodhi të ishte në gjykatë;<sup>29</sup>*

*• Nuk kishte shkelje të Nenit 6(3)(e) sa i përket një interviste të mbajtur në gjuhën frënge nga një zyrtar doganier suedez, pasi që zyrtari kishte ndërmarrë masa të kujdesshme për të kontrolluar nëse komunikimi ishte efektiv dhe si rezultat gjykatau siguria se ishte e sigurve të mbështetej në faktet e marra në ato kontrole.<sup>30</sup>*

Vështirësia me këto vendime është se GJEDNJ në shumicën prej tyre, përcakton vet nëse ka pasur shkelje të Nenit 6(3)(e) apo jo. Prandaj gjetjet janë shumë specifike dhe varen nga ajo se çfarë fakte ka në dosjen që gjendet para GJEDNJ-së. Për këtë arsye, standardi i 'përshtatshmërisë' dhe kërkesat për "ushtrim të kontrollit kur vihet në dijeni" nuk janë standarde veçanërisht të qarta. Shpresohet se Direktiva, e interpretuar nga GjDBE, do të mund të ofrojë disa udhëzime më të qarta.

## C. DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS

### 1. E drejta për interpretim (të cilësisë së mjaftueshme)

Në kuadër të dispozitës kryesore që ka të bëjë me të drejtën për interpretim, pjesët përkatëse të Nenit 2(1), dhe, në veçanti, (8) të Direktivës, specifikojnë:

1. Shtetet Anëtare do sigurojnë se personave të dyshuar ose të akuzuar të cilët nuk e flasin ose kuptojnë gjuhën e procedurave penale në fjalë, pa vonesë, u ofrohet interpretim gjatë procedurave penale para autoriteteve hetuese dhe gjyqësore, përfshirë gjatë marrjes në pyetje në polici, gjatë të gjitha seancave dëgjimore dhe në çdo seancë dëgjimore të ndërmjetme.

(...)

8. Interpretimi i ofruar sipas këtij Neni do të jetë i një cilësie që është e mjaftueshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave, në veçanti duke siguruar që personat e dyshuar ose të akuzuar të kenë njohuri për rastin kundër tyre dhe që janë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbrojtje.'

Ato që do t'i themi në lidhje me këtë janë:

- Ekziston një paralele e qartë mes kërkesës për cilësi në Nenin 2(8) dhe kërkesës së vazhdueshme të GJEDNJ-së të diskutuar më sipër që interpretimi duhet të jetë "i tillë që t'i mundësojë të pandehurit të ketë njohuri për rastin kundër tij dhe të mbroj veten'.
- Kërkesa për cilësi në Nenin 2(8) është e zbatueshme për tërë interpretimin që mbulohet nga ai nen, dhe në pajtim me Nenin 2(1) ekziston vetëm një e drejtë, e zbatueshme që nga fillimi e deri në përmbyllje të procedurave penale. Prandaj, standardi i cilësisë është i zbatueshëm njëjloj si në stacionin policor ashtu edhe në gjykatë.

### 2. Dispozitat që lidhen me kontrollin e cilësisë

<sup>29</sup> *Cuscani v. United Kingdom* App. no 32771/96 (Gjykimi i 24 dhjetorit 2002).

<sup>30</sup> *Diallo v. Sweden*, i përmendur më larët shënimi 1212.



## a. Përgjigje specifike sipas rastit në lidhje me cilësinë

Direktiva po ashtu përmban një sërë dispozitash që në dukje i dedikohen mekanizmave konkret për kontroll të përputhshmërisë me këtë standard. Në veçanti, Direktiva në Nenin 2(5) ofron mundësi për ankesë individuale në lidhje me cilësinë:

‘5. Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar ose të akuzuar, në përputhje me procedurat në të drejtën kombëtare, kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin që thotë se nuk ka nevojë për interpretim dhe në rastet kur është siguruar interpretimi, kanë mundësi të ankohen se cilësia e interpretimit nuk është e mjaftueshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave.’

Në këtë dispozitë nuk është dhënë asgjë në lidhje me natyrën e autoritetit tek i cili mund të bëhet një ankesë e tillë, bazat mbi të cilat duhet bazohet ankesa e kështu me radhë. Më poshtë do t’i japim sugjerimet tona. Megjithatë, pak më shumë detaje janë dhënë në Deklamimet 24 dhe 26:

‘(24) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ka mundësi të ushtrohet kontroll sa i përket përshatshmërisë së interpretimit dhe përkthimit të ofruar në rastet kur autoritetet kompetente janë vënë në dijeni për një rast të caktuar’.

‘(26) Në rastet kur cilësia e interpretimit konsiderohet të jetë e pamjaftueshme për të siguruar të drejtën për gjykim të drejtë, autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje të zëvendësojë interpretimin e emëruar.’

Në lidhje me këto dispozita do të japim disa komente të kufizuara:

- Neni 2(5) parasheh “mundësinë e ankesës” e cila duket të jetë e ndarë nga “e drejta për ankimim”. Është plotësisht e paqartë se çfarë nënkuptohet me këtë por kjo qartazi tregon kërkesën për mbikëqyrje të cilësisë së interpretimit në rastin e caktuar.
- Referenca në Deklamimin 24 për “ushtrim të kontrollit kur vihet në dijeni” është referencë e qartë e konceptit që del nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.
- Deklamimi 26 parasheh një përgjigje ku interpreti zëvendësohet kur zbulohet se cilësia është e pamjaftueshme. Kjo mund të konsiderohet si shembull i ushtrimit të kontrollit kur vihet në dijeni siç parashihet në Deklamimin 24.
- Megjithatë, kjo jo gjithmonë mund të jetë përgjigje e mjaftueshme (p.sh. nëse problemi nuk zbulohet me kohë ose zëvendësimi nuk realizohet megjithëse kërkohet, dhe dëshmitë inkriminuese veçse janë mbledhur përmes interpretimit nën standard). Në këtë moment, mundësia për ankesë ka kuptim vetëm kur konsiderohet si ankesë retroaktive.

## b. Kërkesa të përgjithshme të kontrollit të cilësisë

Direktiva gjithashtu përfshinë kërkesa të përgjithshme të kontrollit të cilësisë në Nenin 5:

“1. Shtetet Anëtare ndërmarrin masa konkrete për të siguruar që interpretimi dhe përkthimi i ofruar është në përputhje me cilësinë e kërkuar në Nenin 2(8) dhe Nenin 3(9).

2. Për të promovuar përshtatshmërinë e interpretimit dhe përkthimit dhe qasjen efikase në to, Shtetet Anëtare përpiqen të krijojnë një regjistër apo regjistra të përkthyesve dhe interpretëve të pavarur që janë të kualifikuar në mënyrën e duhur. Pasi të krijohen, ai regjistër apo ata regjistra, ku është e përshtatshme, vihen në dispozicion të mbrojtësve ligjorë dhe autoriteteve relevante.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që nga interpretët dhe përkthyesit të kërkohet të respektojnë konfidencialitetin sa i përket interpretimit dhe përkthimit të ofruar sipas kësaj Direktive.”

Vëzhgimet tona në lidhje me këto dispozita janë si në vijim:

- Këto duket të jenë detyrime të llojit “sistemik” (d.m.th. jo ato që synojnë t’i japin të drejta individit por ato që kërkojnë nga Shteti Anëtar të ndërmarr masa sistemike).
- Kërkesa në Nenin 5(2) që Shtetet Anëtare të “përpiqen” të krijojnë regjistra të interpretëve të kualifikuar nuk shoqërohet me asnjë kërkesë për përdorimin e interpretëve të tillë në procedura kriminale. Megjithatë, sugjeron se statusi profesional është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë. Kjo gjithashtu është – çuditërisht – dispozita e vetme në Direktivë e cila i referohet “pavarësisë” së interpretuesve në lidhje me cilësinë. Megjithatë, asgjë nuk thuhet në lidhje me atë se çfarë do të ishte kualifikimi i përshtatshëm.

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

### 1. Pika preliminare

Kjo pjesë përmban këshilla për kontrollimin e cilësisë së interpretimit në stacionin policorë, gjë që pjesërisht përbën mbivendosje me këshillat e përgjithshme për punën me interpretë, që në thelb është pyetje më shumë teknike sesa ligjore. Menduam se kjo do të ishte e dobishme: para një trajnimi që është mbajtur kohëve të fundit për Direktivat, 82% e pjesëmarrësve, nga pesë juridiksione, thanë se asnjëherë nuk ishin trajnuar për punën me interpret në raste penale. Fair Trials është organizatë ligjore, jo organizatë e interpretëve, por është konsultuar me disa interpretë brenda rrjetit LEAP për të përgatitur këtë Manual. Ne i referohemi sërish pjesës së punës përgatitore dhe vëmë theksin në vlerën që ka kontakti me interpretë profesional. Udhëzimet e dhëna nga EULITA<sup>31</sup> për shembull, përfshijnë një sërë këshillash praktike për avokatë që punojnë me interpretë, gjë që mund të iu ndihmojë t’i shmangeni kontributit në çështjet e cilësisë.

### 2. Veprimet në fazën paragjyqësore

Të pajisur me të gjitha informatat e nevojshme nga puna përgatitore (shih Pjesën I), ju duhet të jeni të gatshëm të veproni kur shkoni në stacionin policor për ta përfaqësuar një person i cili nuk

<sup>31</sup> EULITA / Asociacioni i Avokatëve Penal të Evropës, Vademecum: Udhëzues për komunikim më efektiv me interpretë dhe përkthyes gjyqësor, mund ta gjeni (në anglisht) në <http://www.eulita.eu/fr/documents-pertinents>.

flet apo kupton gjuhën e procedurave penale. Siç është shënuar më lartë, kërkesa për interpretim adekuat zbatohet që nga marrja në pyetje në polici, aty ku është e nevojshme për të ruajtur drejtësinë e procedurave, edhe në mes të klientit dhe avokatit. Në të njëjtën mënyrë edhe veprimet e tua për të siguruar përputhshmëri me Direktivën duhet të fillojnë në stacionin policor.

Natyrisht, duhet të mbani në mend se policia ka gjasë të mos jetë edhe aq pranuese kundrejt arsytimit ligjor që kanë të bëjnë me Direktivën, e edhe më pakë të parimeve më të gjera të së drejtës së BE-së, gjatë kohës së shkurtër që kanë në dispozicion për kryerjen e intervistës para se i dyshuari të dërgohet para një gjykatësi.

Megjithatë, ju sërish duhet të merrni veprime në stacionin policor. Së pari, policët mund të përgjigjen në ankesat tuaja (veçanërisht, siç u përmend më lartë, nëse ankesa juaj është pjesë e një modeli), dhe kjo mund të ndihmojë në adresimin e çështjes së cilësisë. Dhe po aq e rëndësishme, duhet që çështja e cilësisë të ngritet gjatë procedurave në stacionin policor për të siguruar një bazë mbi të cilën më vonë mund të kërkoni nga gjykata t'i adresohet dëshmive në një mënyrë tjetër. Paragrafi në vijim përmban disa sugjerime se si të veprohet në situata specifike.

## **a. Para se të fillojë marrja në pyetje**

### ***i. Konsultimi me klientin para marrjes në pyetje***

Sipas njohurive të Fair Trials, ekzistojnë praktika të ndryshme në lidhje me faktin se (i) a sigurohet një interpret për konsultime në mes të klientëve dhe avokatit dhe (ii) nëse ky është i njëjti interpret i cili më pastaj ndihmon gjatë marrjes në pyetje në polici. Shihni pjesën I në lidhje me vendimin nëse duhet caktuar një interpret për këtë qëllim apo jo. Nëse caktohet një interpret, atëherë kjo është mundësia e parë për ju që të vlerësoni cilësinë e interpretimit dhe ndikimin e tij në besueshmërinë e dëshmive të marra. Shihni pjesën “qasje e përgjithshme për marrje në pyetje” më poshtë”, që i zbatohet “mutatis mutandis” për konsultimet e juaja me klientin.

### ***ii. Hapat fillestarë***

Është e mundshme që të filloni të merrni gjykime të informuara në lidhje me cilësinë e interpretimit të ofruar para se të fillojë marrja në pyetje, duke mësuar për personin i cili do të ofrojë shërbimin. Gjëja kryesore është të:

→ Mësoni për interpretin dhe kompetencën e tij:

- Pyetni policët/interpretin për kualifikimet dhe përvojën e interpretit: kualifikimet dhe anëtarësimet profesionale, vitet e përvojës etj.
- Kontrolloni nëse interpreti flet gjuhën e njëjtë (dhe dialektin, ku është relevante) të kërkuar nga klienti juaj, apo diçka të ngjashme me të (p.sh. gjuha Ruse, Ukrainase dhe Kazake janë të lidhura dhe paka a shumë të ngjashme, por jo identike).
- Kontrolloni cilat janë gjuhët ‘A’, ‘B’ dhe ‘C’ të interpretit. Shumë interpretë përdorin këtë sistem për të identifikuar gjuhët të cilat i zotërojnë më mirë (A më së miri, C më së paku). Pyetni interpretin; nëse nuk e din se për çka e keni fjalën, mbani shënim këtë.
- Pyetni policët të shpjegojnë arsyet mbi të cilat e kanë përzgjedhur këtë interpret (p.sh. rrjedhshmëria e të folurit të gjuhës, anëtarë i komunitetit lokal të mërgatës, është përdorë në raste të kaluara etj.).

Informacioni që do të merrni për interpretin do të jetë i rëndësishëm jo vetëm për arsye se do të iu ndihmojë të vendosni si të veproni më tej, por gjithashtu mund të jetë i rëndësishëm më vonë në gjykatë ose apelim. Ngjashëm ju duhet të:

- Siguroni që mbahen shënime të detajeve për interpretin
- Mbani edhe vet shënime për informatat që merrni.
- Kërkoni nga interpreti të nënshkruaj shënimet dhe të ofrojë kopje të kredencialeve të tij.
- Kërkoni që këto informata të regjistrohen në protokollin e policisë/regjistrin e mbajtjes (nëse një gjë e tillë nuk ekziston, kërkoni që të shënohet në fillim të intervistës).

### **iii. Nëse interpreti është i pakualifikuar**

Nëse jeni i pakënaqur nga fakti që interpreti nuk është i kualifikuar sa duhet, mund të jetë e nevojshme që të kërkoni caktimin e një interpreti të kualifikuar para fillimit të intervistës. Nëse, për shembull, keni kuptuar që interpreti është thjeshtë anëtar i komunitetit lokal të emigrantëve i cili flet gjuhën e të dyshuarit, nuk ka asnjë bazë për juve që të supozoni se ai ka kompetencë për të kryer punën. Prandaj ju duhet të:

- Kërkoni zëvendësimin e interpretit të pakualifikuar me një profesionist
- Sillni në vëmendje të policëve ndonjë dokument kombëtar (udhëzues etj.) dhe shpjegoni pse interpreti nuk plotëson ato.
- Siguroni që kjo kërkesë të regjistrohet në shënimet e policisë.
- Nëse kërkesa refuzohet, arsyet e refuzimit mbahen shënim.

Është e mundshme, madje ka shumë të ngjarë, që një kërkesë e tillë të mos pranohet. Nëse policia e ka zakon të përdorë një interpret të caktuar, ose thjeshtë nuk ka interpret tjetër në dispozicion në nivel lokal që ofron shërbimin në gjuhën e kërkuar, deri në masën ku refuzimi për të vazhduar me intervistë mund të vonojë hetimet, gjë që ka mundësi të ndikojë në mundësinë që klienti të lirohet në këtë fazë, ju duhet të keni parasysh obligimet tuaja deantologjike/etike ndaj klientit tuaj. Megjithatë, qëllimi është të sigurohet që marrja në pyetje nuk do zhvillohet përmes një interpreti që nuk plotëson standardet; por nëse vendoset të vazhdohet pa marr parasysh kundërshtimin tuaj, pavarësisht se a e këshilloni klientin tuaj të mos flas apo diçka tjetër, është esenciale që të mbahet shënim kundërshtimi i juaj.

## **b. Qasja e përgjithshme për marrje në pyetje**

### **i. Njoftoni klientin me problemet e interpretimit**

Gjithmonë duke iu nënshtruar rregullave deantologjike, është e këshillueshme ta njoftoni të dyshuarin se ekziston rreziku që të keqkuptohen nëse flasin shumë gjatë, gjë që do ta detyronte interpretin të bëjë përmbledhje dhe parafrazime. Do të ishte e pakundërshtueshme, në kuptimin

etik, të sigurohet se klienti ka një mundësi të mirë që të kuptohet drejtë. Prandaj:

→ Përgatitni klientin:

- Tregoni se është mirë që të mos flasin shumë shpejt, dhe të bëjnë pauza ndërmjet fjalive në mënyrë që interpreti të mund të interpretojë secilën fjalë. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e mundësisë për gabim.
- Sigurisht, kjo nuk duhet të përzihet në asnjë mënyrë me këshillën që i jepni klientit se në cilat pyetje duhet të përgjigjen e në cilat jo.

## **ii. Mbajtja e shënimeve**

Shënimet e marrjes në pyetje në polici mund të mbahen në forma të ndryshme. Në disa juridiksione, si në Mbretërinë e Bashkuar, marrja në pyetje regjistrohet në kasetë në mënyrë sistematike. Në vende tjera, praktika është që të merren shënime të asaj që është thënë gjatë marrjes në pyetje dhe pastaj të kërkohet nga i dyshuari që ta nënshkruaj atë. Për ju është e rëndësishme të siguroni që çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin të regjistrohet sa më mirë që është e mundur. Ne propozojmë:

→ Sugjerime për mbajtje të shënimeve:

- Pyetni nëse mund ta incizoni intervistën në një pajisje të dorës.
- Nëse kjo gjë nuk lejohet, kërkoni që refuzimi të shënohet në shënimet e intervistës.
- Merrni edhe vetë shënime për çështjet që ngritën gjatë intervistës.
- Kërkoni që një kopje e shënimeve tua të shtohet në dosje, nëse është e mundur.

Sigurimi se ka dëshmi adekuate të çështjeve që janë ngritur gjatë marrjes në pyetje do të jetë e dobishme më vonë nëse kërkohet nga ju që të vërtetoni ndonjë argument që ka të bëjë me dështimin e policisë për respektuar Direktivën.

## **iii. Çka duhet pasur kujdes – në përgjithësi**

Sigurisht që avokatet nuk mund të identifikojnë ‘gabimet’ përveç nëse ndodhë që të flasin dy gjuhët rrjedhshëm. Por mund të jetë këtë mundësi të identifikohen çështje dhe fusha ku ka dyshim, të cilat mund të arsyetoni më vonë që të zgjidhen në favor të klientit tuaj në mungesë të regjistrimit pozitiv (siç është incizimi).

Derisa i kushtoni vëmendje çështjeve që kanë të bëjnë me cilësinë e interpretimit, vlen të mbahet në mend standardi i caktuar nga Neni 2(8) i Direktivës (“sigurimi që personat e dyshuar ose të akuzuar kanë njohuri për rastin kundër tyre dhe kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre për mbrojtje”). Prandaj pyetja kryesore është nëse personi është në gjendje të kuptojë për çfarë po akuzohet dhe të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën për mbrojtje. Në kontekstin e marrjes në pyetje në stacionin policor, duke supozuar se nuk është marrë vendimi për të heshtur, gjëja kryesore që duhet të merret parasysh sa i përket ushtrimit të së drejtës për tu mbrojtur është të kuptuarit e pyetjeve që parashtrohen dhe aftësia për t’u shpjeguar. Në të vërtetë, siç u përmend më lartë, standardi i GJEDNJ-së i referohet mundësisë së të dyshuarit që

të “tregoj versionin e tyre të ngjarjeve”. Prandaj:

→ Mbani parasysh këto pyetje:

- A është në gjendje i dyshuar t'i kuptojë saktësisht pyetjet që i shtrohen atij?
- A është në gjendje i dyshuari të japë versionin e tij të ngjarjeve me saktësi?
- A paraqitet ndonjë rrezik për padrejtësi për shkak të interpretimit?

#### ***iv. Çka duhet pasur kujdes – çështjet specifike***

Shkalla e përmbushjes së këtij standardi do të varet nga një numër i aspekteve konkrete dhe praktike të interpretimit të ofruar gjatë asaj dite. Nën-titujt në vijim mbulojnë disa fusha kyçe ku më së shumti ka gjasë të ngritën probleme sa i përket interpretimit.

##### **▪ *Pyetjet kontrolluese***

Është praktikë e mirë që intervistuesi përmes interpretit të bëjë disa pyetje në fillim të intervistës për të përcaktuar nëse personi është në gjendje të kuptojë çfarë po flitet.

→ Merrni shënime për pyetjet e kontrollit dhe përgjigjet e dhëna.

→ Nëse nuk bëhen pyetje të kontrollit, sugjeroni që të bëhen.

##### **▪ *Deklaratat inkriminuese***

Funksioni i interpretimit është që deklaratat e bëra nga i dyshuari t'i konvertojë në gjuhën e synuar. Nëse kjo nuk bëhet si duhet, një deklaratë shfajësuese mund të keqkuptohet dhe të regjistrohet si deklaratë inkriminuese.

Për shembull, nëse i dyshuari thotë se ‘e kapi paniku’ dhe e goditi dikë, dhe kjo interpretohet si të thoshte ‘e humbi toruan’ dhe e goditi dikë, kjo do të ishte e pasaktë. Deklarata e parë është në thelb shfajësuese, duke sugjeruar vetëmbrojtje, deklarata e dytë është në thelb inkriminuese, duke sugjeruar reagim të dhunshëm. Apo nëse i dyshuari deklaron se një shok i ka dhënë ca para për të blerë drogë për të dy, kjo mund të interpretohet gabimisht duke aluduar se ai e ka blerë tërë sasinë me synim që gjysmën të ia shesë shokut të tij. Deklarata e parë do të nënkuptonte thjeshtë posedim të drogës, kurse e dyta mund të kuptohet si qëllim për furnizim, që është shkelje më e rëndë.

→ Qartësoni deklaratat që mund të jenë të dykuptimta ose inkriminuese.

→ A ka përdorur interpreti përkthim fjalë për fjalë apo një shprehje?

→ Cilat ishin fjalët e sakta të përkthyer?

- Nëse e konsideroni se nuk është potencialisht paragjyquese ndaj interesave të klientit tuaj, pyetni (ose kërkoni nga policët të pyesin) të dyshuarin me pyetje shtesë për të qartësuar dykuptimësitë potenciale gjatë intervistës.
- Përndryshe, kërkoni një mundësi për t'i shikuar shënimet e intervistës, pasi të jenë printuar, privatisht me klientin para se t'i nënshkruaj ato. Kjo, sigurisht, do të duhej të bëhet me interpretin e njëjtë.

▪ **Problemet me interpretimin konsektiv**

Interpretimi në një stacion policor vështirë se mund të ndodhë të bëhet në mënyrë “simultane”, pasi që rrallëherë mund të ketë pajisje në dispozicion. Ka më shumë gjasë që secila pyetje të përkthehet nga interpreti për të dyshuarin. Pastaj përgjigja e të dyshuarit do të përkthehet nga interpreti për hetuesin. Kjo njihet si “interpretim konsektiv”

Ka teknika të ndryshme: nganjëherë interpreti pretë që folësi të japë një pjesë të përgjigjes, kërkon nga ai që të ndalet, e përkthen atë pjesë, pastaj lejon që folësi të vazhdojë, duke përsëritur këtë proces në vazhdimësi. Përndryshe, interpreti mund të marr shënime të asaj që thuhet nga folësi, e pastaj e ritregon dëshminë për dëgjuesin.

Interpretët profesional janë të trajnuar që ta përkthejnë në gjuhën e synuar saktësisht atë që e thotë folësi, pa e sintetizuar përgjigjen e folësit në fjalët e veta. Megjithatë, kjo është një shkathtësi e vështirë dhe, siç kanë raportuar ekspertët tanë në Fair Trials, shumë prej atyre që ofrojnë shërbime interpretimi në stacionet policore në BE nuk janë interpretë profesional të kualifikuar.

Përveç kësaj, përderisa zyrtarët policorë mund të jenë të trajnuar në teknika të marrjes në pyetje dhe bëjnë pyetje të qarta e të fokusuara, i dyshuari, për të cilin mund të jetë hera e parë që gjendet në një stacion policor, mund të jetë i shqetësuar ose të ketë frikë. Ka mundësi që përgjigjet e tyre të jenë të paqarta, me shumë fjalë apo të formuluar keq, që do të paraqitnin sfidë edhe për interpretët gjyqësorë me shumë përvojë.

Prandaj ekziston mundësia që interpretët të transmetojnë të kuptuarit e tyre të asaj që është thënë nga i dyshuari, duke i shpjeguar hetuesit atë që ka thënë i dyshuari. Është e qartë se kjo ndikon në mundësinë që i dyshuari të paraqes “versionin e tij të ngjarjeve”.

- Tërhiqni vëmendjen për dështimet e dukshme në përkthim:
  - Potenconi rastet kur gjatësia e deklaratës së përkthyer dallon në masë të konsiderueshme nga gjatësia e deklaratës së dhënë nga personi.
  - Nëse e dëgjoni një fjalë të përsëritet disa herë nga klienti gjatë një deklarate, dhe nuk e dëgjoni të përmendet po aq herë në interpretim, potenconi atë.

▪ **Leksiku**

Në disa raste, marrja në pyetje në polici mund të lidhet me fusha të ekspertizës profesionale, shkencore ose teknike. Është e qartë që në këtë rast, mundësia e interpretit për të kuptuar terminologjinë e përdorur nga folësi do të varët nga diapazoni i vokabularit të tij në të dy gjuhët. Edhe në kontekste të thjeshta biznesi, fjalët ‘të hyra’ dhe ‘të ardhura’ mund të rezultojnë në

deklarata inkriminuese varësisht se si përkthehen ato. Megjithatë, edhe në kontekste krejt të thjeshta, nëse interpreti nuk është mjaftueshëm kompetent, ai mund të ketë telashe edhe me shprehjet bazike.

- Shikoni për shenja që tregojnë se interpreti nuk i din fjalët që përdoren.
- A po bënë interpreti pauza të gjata për të përkthyer në një mënyrë apo tjetër?
- A po e pyet interpreti të dyshuarin për të qartësuar ato që thotë?
- Çfarë janë reagimet e të dyshuarit në raport me interpretimin?

▪ **Interpretimi në vetën e parë**

Një interpret që interpreton me besnikëri do të përdorë mënyrën e të folurit që e përdorë folësi. Kjo do të thotë se interpreti, gjatë intervistimit në polici, duhet të përgjigjet në vetën e parë, pra ‘nuk e kam parë asnjëherë më parë këtë person’, e jo ai/ajo thotë e nuk e ka parë asnjëherë më parë këtë person’.

- Nëse interpreti përdorë vetën e tretë në vend të vetës së parë, tërhiqni vëmendjen e policëve në këtë fakt dhe sigurohuni që kjo gjë regjistrohet.

▪ **Interpreti e “këshillon” klientin**

Praktikuesit shpeshherë raportojnë se interpretët bisedojnë me klientin gjatë intervistës, si për të qartësuar deklaratat ashtu edhe për t’i këshilluar ata se çfarë duhet të thonë. Është e qartë se, nëse kjo ndodhë, ngrit pyetjen nëse informacioni që po regjistrohet është në të vërtetë i të dyshuarit apo jo.

- Kërkoni nga interpreti që të qartësojë bisedën që po e bën me klientin.
- Mbani shënime.

**c. Ankimi për cilësinë e interpretimit**

Nëse, për çfarëdo arsye, nuk jeni të kënaqur me nivelin e cilësisë së interpretimit, ju duhet të ankoheni për cilësinë e dobët. Mos harroni se Neni 2(5) përcakton se të dyshuarit kanë nevojë për “mundësinë që të ankohen” në lidhje me cilësinë.

**i. Gjatë intervistës**

Ju duhet që paraprakisht të identifikoni nëse ekziston ndonjë regjim ligjor që lejon bërjen e ankesave gjatë kohës së hetimeve policore. Megjithatë, nëse është e mundshme, duhet të ankoheni drejtpërsëdrejti tek zyrtari intervistues ose tek një autoritet më i lartë. Prandaj:

- Veproni
- Informoni zyrtarin intervistues për shqetësimet tua në lidhje me interpretimin.
- Kërkoni që interpreti të zëvendësohet.
- Siguroni që ankesa është shënuar.
- Kërkoni që intervista të fillojë sërish nga fillimi me një interpret të ri, duke shpërfillur intervistën paraprake.



## ii. Pas intervistës:

Duhet të “ankoheni” para autoritetit kompetent i emëruar për këtë qëllim sipas ligjit kombëtar. Nuk do të thotë që patjetër duhet të jetë vetë gjykata penale. Megjithatë, është me rëndësi ti shfrytëzoni rrugët e tilla ligjore që keni në dispozicion. Kjo mund të sigurojë ofrimin e një shërbimi më të mirë në intervistën pasuese, nëse ka të tillë. Përveç kësaj, mos parashtrimi i një ankese në këtë moment mund të përjashtojë mundësinë për kundërshtim të mëvonshëm, d.m.th. kur të kërkonte nga gjykata që të shpërfillë/anulojë intervistën.

→ Identifikoni autoritetin kompetent dhe ankohuni.

- Paraqitni një kopje të shënimeve që keni marr.
- Identifikoni çështjet specifike që iu kanë shtyrë të besoni se ka probleme në lidhje me cilësinë.
- Shpjegoni pse besoni se ato do të shkaktojnë padrejtësi. Për shembull, potenconi nëse besoni se klienti nuk kishte mundësi të paraqiste versionin e tij të ngjarjeve, ose nuk kishte kuptuar plotësisht pyetjet që i ishin shtruar.

Rezultati i një ankese të tillë mund të jetë dëshmi e rëndësishme. Nëse, për shembull, mënyra e vetme është që të ankoheni tek shërbimi i interpretimit, dhe ata dakordohen që ka pasur probleme dhe sigurojnë një interpret tjetër, kjo do të jetë e dobishme për të treguar se interpretimi ka qenë nën standarde kur të vijë koha t’i adresoheni gjykatës për mënyrën e trajtimit të provave.

## 3. Paraqitja e argumenteve në gjykatë

### a. Detyra e gjykatës për të siguruar interpretim adekuat

Siç e pamë në përmbledhjen e Direktivës, e drejta për interpretim adekuat është e zbatueshme njëlloj edhe në gjykatë. Është plotësisht e qartë se gjykata duhet të sigurojë që interpretimi në proceset e veta është i një cilësie të mjaftueshme për të mbrojtur drejtësinë e procedurave. Të gjitha sugjerimet e dhëna më lartë në lidhje me stacionin policor janë njëlloj të zbatueshme: jini të vëmendshëm në lidhje me standardin e interpretimit dhe kërkonte zëvendësim të interpretit kur është e mundur.

### b. Obligimi i gjykatës në raport me interpretimin joadekuat në stacionin policor: “Ushtrimi i kontrollit” kur “vihet në dijeni”

Pyetja më e rëndësishme këtu është se çfarë duhet të bëjnë gjykatat, përfshirë edhe gjykatat e instancës së parë, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë e interpretimit gjatë fazës së seancave paraprake. Direktiva nuk e adreson këtë çështje në mënyrë eksplicite. E drejta e përcaktuar në Direktivë është e drejta për interpretim “adekuat” dhe qëllimi i saj siç e kemi parë është “mbrojtja e drejtësisë së procedurave”.

Logjikisht, nëse është ofruar interpretim joadekuat në stacionin policor, por pavarësisht kësaj deklarata e regjistruara janë përdorur për ta dënuar personin, kjo shkakton padrejtësi, dhe rrjedhimisht nuk është përmbushur objektivi. Prandaj, nëse ndodhë një shkelje, gjykata duhet

të ofrojë masa korigjuese (shih Manualin 'Përdorni i të drejtës së BE-së në praktikë). Gjykatat kombëtare mund të jenë përgjegjëse, sipas të drejtës kombëtare, që të marrin në konsideratë çështjet që lidhen me interpretimin gjatë marrjes në pyetje kur vlerësojnë provat ose kur konsiderojnë kërkesat për anulim.

Megjithatë, në direktivë mund të jetë përfshirë parimi i korigjimit. Siç u përmend më sipër Direktiva synon të lehtësojë zbatimin e të drejtës për asistencë gjuhësore që del nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, dhe duhet të zbatohet dhe aplikohet në mënyrë konsistente me të. Praktika gjyqësore paraqet një qasje ku gjykatat duhet të "ushtrojnë kontroll" kur "vihen në dijeni" për çështje që lidhen me interpretimin.

### ***i. Parimi rudimentar i "kontrollit retroaktiv" në rastin Diallo v. Suedisë***

Siç e pamë më herët, rasti *Diallo v. Suedisë*, ishte ai i cili e përcaktoi të drejtën për interpret në stacionin policor. Autoritetet doganore suedeze kishin arrestuar një shtetase francez, e cila nuk fliste suedisht, për veprën e importimit të heroinës. Fillimisht ishte realizuar një intervistë pa praninë e një interpreti, ku zyrtari doganor ("AS") kishte bërë intervistën në gjuhën frënge. E dyshuara kishte deklaruar se pakot të cilat i kishte në posedim përmbanin një substancë për larjen e parave. Pastaj ishte mbajtur një intervistë tjetër, këtë herë me një interpret të autorizuar i cili asistonte përmes telefonit, ku po kjo deklaratë ishte përsëritur. Në intervistat pasuese dhe në gjykatë ajo tha se nuk kishte dijeni se çfarë përmbanin pakot. Gjykata e apelit u mbështet në këtë mospërputhje për të vendosur se ajo ishte jo-kredibile. Duke bërë këtë, gjykata theksoi se intervistuesi që fliste gjuhën frënge kishte bërë disa pyetje të kontrollit, dhe se thjesht nuk kishte asnjë mundësi që ajo të kishte keqkuptuar deklaratën fillestare. GJEDNJ deklaroi:

23. (...) detyrimi i autoriteteve kompetente nuk kufizohet në emërimin e një interpreti por, nëse vihen në dijeni në rrethana të veçanta, mund të zgjerohen më tej dhe të bëjnë kontrolle të përshtatshme të interpretimit të ofruar.

(...)

29. Gjithashtu, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit ka ushtruar nivel të mjaftueshëm të kontrollit sa i përket mjaftueshmërisë së shkathtësive të "AS" për interpretim.

30. Për më tepër, Gjykata konstaton se deklarata e kontestuar e aplikueses "që pakot përmbanin një produkt për larjen e parave" ishte vetëm një prej shumë dëshmimeve në procedurat penale kundër saj dhe se nuk ka asgjë që nënkuptonte se ajo deklaratë ishte vendimtare për rezultatin përfundimtar të rastit.

31. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se aplikuesja ka pasur asistencë të mjaftueshme gjuhësore gjatë intervistës së parë me Doganën Suedeze.<sup>32</sup>

Ky është i vetmi vendim i GJEDNJ-së që në mënyrë eksplicite sugjeron se "ushtrimi i kontrollit mbi mjaftueshmërinë e interpretimit", siç është përmendur në rastin *Hacioglu v. Romania* (të përmendur më lartë) dhe në Deklamimin 24 të Direktivës, nënkupton se një gjykatë gjatë marrjes së vendimit për përmbajtjen e rastit, nëse vihet në dijeni për cilësinë e interpretimit të ofruar në fazën paraprake, duhet të marr parasysh – në mënyrë retroaktive – mjaftueshmërinë e atij

<sup>32</sup> Diallo v. Sweden, i përmendur më lartë shënimi 12, paragrafët 23, 29-31.

interpretimi (paragrafi 29, *Diallo*) kur bënë vlerësimin e provave. Rasti i veçantë u hodh poshtë si i papranueshëm, por ky arsyetim ligjor vlen të përmendet.

## **ii. Krijimi i një detyrimi për kontroll retroaktiv sipas Direktivës**

Siç edhe përmendet në Manualin “Përdorimi i të drejtës së EU-së në praktikë”, fakti që Direktiva është e heshtur sa i përket çështjes së mjeteve korrigjuese ligjore nuk përbën fundin e analizës. Interpretimi në stacionin policor rregullohet nga e drejta e BE-së, prandaj kjo çështje është brenda fushëveprimit të së drejtës së BE-së, që përfshinë zbatimin e të drejtave themelore të garantuara me Kartë. Këto përfshijnë të drejtat për mbrojtje që garantohen nga Neni 48 i kartës, bazuar në Nenin 6(3) të KEDNJ-së dhe duhet të interpretohen në të njëjtën formë. Sugjerimi tentativ por i qartë i praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është se kontrolli duhet të ushtrohet në mënyrë retroaktive nga gjykata për të kontrolluar besueshmërinë e dëshmive para se t’i marr për bazë ato. Prandaj argumenti që ne propozojmë është ky:

→ Argumentoni: Vendimi në rastin *Diallo v. Sweden* tregon se për të “ushtruar kontroll mbi mjaftueshmërinë e interpretimit”, siç kërkohet nga Deklamimi 24 i Direktivës dhe nga Karta, gjykata për të arritur në një vendim sa i përket përmbajtjes, duhet të merr parasysh cilësinë e interpretimit të ofruar gjatë marrjes në pyetje në polici. Ngjashëm, kjo qasje duhet të aplikohet edhe sipas Direktivës.

Natyrisht, nëse konstatohet se ka pasur shkelje të kërkesës për cilësi, atëherë gjykata duhet të bëjë gjithçka që është në juridiksionin e saj për të rregulluar gjërat (duke shpërfillur provat, duke mos u dhënë rëndësi apo duke i dhënë rëndësi të pakët atyre, ose duke bërë të pavlefshme marrjen në pyetje për shkak të mospërputhjes me Direktivën).

## **c. Paraqitja e argumenteve**

### **i. Përdorni shënimet që keni marr në stacionin policor**

Nëse e bindni gjykatën se ekziston detyrimi që Gjykata, gjatë shqyrtimit të dëshmive të marra përmes interpretit me rastin e marrjes në pyetje në polici, të marr në konsideratë edhe dështimet që kanë ndodhur më herët në procedurë, atëherë të gjitha dëshmitë që keni marr në stacionin

→ Paraqitni dëshmitë/shënimet që keni mbledhur në stacionin policor, duke shpjeguar se si kjo tregon mos-pajtueshmëri me kërkesën e Direktivës për cilësi.

policor (shënimet etj.) do të bëhen relevante.

Kjo do të jetë veçanërisht e dobishme nëse Shteti Anëtar ka dështuar të krijojë një sistem për të vërtetuar nëse interpretimi në një rast të caktuar është i një standardi të kënaqshëm.

### **ii. Bazohuni në dështimin për ndërmarrjen e “masave konkrete”**

Më herët pamë se Neni 5(1) kërkon nga Shtetet Anëtare të ndërmarrin “masa konkrete” për të siguruar interpretim adekuat. Kjo duket se u lejon Shteteve Anëtare një diskrecion të gjerë mbi atë se çfarë duhet të bëjnë. Megjithatë, Direktiva kërkon që të ndërmarrin ndonjë veprim. Vlen të rikujtohet se kërkesa për cilësi në Nenin 2(8) përcakton se interpretimi duhet të “ketë cilësi të mjaftueshme për të mbrojtur mbarëvajtjen e procedurave”. Është e qartë se “procedurat” mund t’i referohen vetëm një rasti të caktuar ku është ofruar interpretimi. Prandaj edhe nëse ndërmerren masa të përgjithshme (p.sh. vendosja e kriterëve hyrëse për profesionin e interpretit), duhet gjithashtu të vendoset diçka për të siguruar cilësi në raste specifike (kjo mund të përfshijë, veçanërisht, regjistrim audiovizuel të intervistave). Ju mund të bazoheni në dështime për të ndërmarrë masa të tilla. Kjo do të ketë fuqi të veçantë nëse, siç u shpjegua më lartë, arsyetimi juaj mbështetet me materiale që tregojnë se gjërat në të vërtetë kanë shkuar keq me interpretim në stacionin policor.

→ Argumento: Kur ngrihet një çështje që ka të bëjë me interpretimin, duhet pasur parasysh se deri në çfarë mase Shteti Anëtar ka ndërmarrë “masa konkrete” për të siguruar që interpretimi të përmbushë standardet e kërkuara. Dështimi për të vendosur një sistem që është i aftë për të siguruar mjaftueshmëri të interpretimit në procedurat specifike në fjalë do të thotë se nuk ka garanci të mjaftueshmërisë së interpretimit. Gjykata duhet ta marr këtë fakt parasysh me rastin e marrjes së vendimit.

### ***iii. Standarde të ndryshme në stacionin policor dhe në gjykatë***

Direktiva, siç u tha më lart, siguron një të drejtë të vetme për interpretim adekuat e cili zbatohet gjatë gjithë procedurës penale nga marrja në pyetje në polici deri tek ankesat përfundimtare. Në disa vende, institucionet paragjyqësore dhe gjykatat përdorin të njëjtat shërbime, por në bazë të informacionit tonë, disa vende kanë sisteme të ndryshme për policinë dhe gjykatat. Zakonisht raportohet se sistemi në stacionin policor është shumë më joformal dhe me më pak garanci të cilësisë. Nëse ky është rasti në vendin tuaj, mund të përpiqeni ta potenconi këtë dallim.

→ Arsyetoni: dallimet në mes të sistemeve të interpretimit në stacionin policor dhe në gjykatë do të thotë se standardi i cilësisë nuk plotësohet në nivel të policisë, duke iu referuar:

- Legjislacionit i cili rregullon secilin nga sistemet (ose mungesës së legjislacionit specifik, nëse ky është rasti);
- Strukturave të ndryshme për të sy sistemet (organe profesionale, sisteme disiplinore dhe të sigurimit të cilësisë etj.);
- Standardeve të qasjes në secilin prej sistemeve, në lidhje me kualifikimet profesionale.

Prandaj ju mund të bindni gjykatën që të ndërmarrë veprime korigjuuese sa i përket procedurave policore, duke u mbështetur në faktin se shërbimi nuk është i standardit të njëjtë me atë që ofrohet në gjykatë, e që është në kundërshtim me Direktivën.

## III – PROBLEMI I “GJUHËS SË TRETË”

### A. PROBLEMI

---

Në këtë pjesë, propozojmë rishikimin e shpejtë të çështjes që ka të bëjë me ofrimin e interpretimit në një gjuhë tjetër nga gjuha amtare e të dyshuarit (një ‘gjuhë të tretë’). Për ta ilustruar me një shembull, praktikantët kanë raportuar se Kazakëve iu ofrohet interpretim në gjuhën Ruse. Kjo gjë shkakton problemet e njëjta sikurse përkthimi i dobët: mundësinë për keqkuptim, gjë që mund ta cenojë mbarëvajtjen e gjykimit.

### B. BAZA E KEDNJ

---

Deri më tani, kjo çështje nuk është shqyrtuar në detaje nga GJEDNJ. Në rastin që është në pritje *Vizgirda v. Slovenia*<sup>33</sup> një shtetasit lituanez i është ofruar interpretim në gjuhën ruse, që nuk është gjuha e tij amtare. Fair Trials ka intervenuar<sup>34</sup> në këtë rast për të ngritur çështjet si më poshtë:

- Pozita e një personi të dyshuar ose të akuzuar të cilit i ofrohet interpretim në një gjuhë që nuk është gjuha e tij amtare është e krahasueshme me pozitën e të dyshuarit i cili flet gjuhën e forumit në nivel të ulët si gjuhë e dytë.
- Prandaj, të gjithë faktorët që zakonisht janë të rëndësishëm për të përcaktuar nëse dikush ka nevojë për interpretim janë relevant për të përcaktuar nëse interpretimi në një gjuhë të tretë është zgjidhje adekuate: a posedon personi në fjalë shkathtësitë e nevojshme gjuhësore në atë gjuhë, marr parasysh seriozitetin e veprës, që kjo zgjidhje të jetë adekuate?
- Ofrimi i interpretimit në një gjuhë të tretë duhet automatikisht të “vë në dijeni autoritetet”, duke nxitur kështu obligimin e tyre për të “ushtruar kontrollin”. Kjo do të nxisë veprime për të verifikuar cilësinë e interpretimit, ose veprime retroaktive për të kontrolluar besueshmërinë e deklaratave të marra gjatë procedurave të mëhershme.

### C. DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS

---

Vetëm një dispozitë e Direktivës, Deklarata 22, përmend këtë pikë:

‘Interpretimi dhe përkthimi sipas kësaj Direktive duhet të ofrohet në gjuhën amtare të personit të dyshuar ose të akuzuar ose në ndonjë gjuhë tjetër që ata e flasin ose e kuptojnë për të iu krijuar atyre mundësi që ta ushtrojnë në plotësi të drejtën e tyre për mbrojtje, dhe për të ruajtur mbarëvajtjen e procedurave.’

### D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

---

Ju inkurajojmë që të trajtoni ofrimin e interpretimit në një gjuhë të tretë njëjtën sikur mos ofrimin e interpretimit për dikë që nuk flet gjuhën e forumit si gjuhë të parë.

---

<sup>33</sup> *Vizgirda v. Slovenia*, App. nr. 59868/08, komunikuar më 16 qershor 2014.

<sup>34</sup> Lexoni intervenimin [këtu](#).

Ngjashëm, gjithçka që është thënë në kontekst të Pjesës I dhe II më lartë zbatohet, *mutatis mutandis*, në lidhje me ofrimin e asistencës gjuhësore në një gjuhë të tretë.

## 1. Kundërshtimi i një vendimi për ofrim të interpretimit në gjuhë të tretë

- Referojuni intervenimit të Fair Trials në rastin *Vizgirda v. Slovenia* dhe Pjesës I më lartë.
- Mundohuni ta kuptoni (madje edhe duke përdorë pajisje mobile) nëse gjuhët janë të ngjashme dhe në çfarë mase, p.sh a përdorin alfabetin e njëjtë?
- Shpjegoni, në momentin kur është duke u bërë vlerësimi dhe duke u marr vendimi:
  - Gjuha amtare e të dyshuarit nuk është gjuha e propozuar për interpretim dhe duhet të bëhet një vlerësim i nivelit në të cilin i dyshuari është në gjendje të kuptojë pyetjet dhe të përgjigjet në to në gjuhën e tretë të propozuar, duke iu referuar fakteve specifike të rastit. Shpjegoni se, sipas gjykimit të GjEDNJ-së për rastin *Brozicek v. Italy*<sup>35</sup>, për ta përdorur një gjuhë të tretë është detyrë e autoriteteve të përcaktojnë nëse personi e flet atë gjuhë në nivel të mjaftueshëm.
  - Përdorimi i një gjuhe të tretë do ta detyrojë të dyshuarin të komunikojë në mënyrë jo-perfekte dhe kjo do të cenojë aftësinë e tij për t'u shprehur qartë në lidhje me çështje kyçe. Siguroni që ky kundërshtim të shënohet në procesverbal/ mbani shënim edhe për vete.

## 2. Ankimi për interpretim joadekuat

### a. Në intervistimin fillestar

- Referojuni Pjesës II më lartë. Të gjitha adresimet e njëjta janë relevante.
- Përveç kësaj, kërkoni nga klienti juaj, përmes interpretit, të ju tregojë nëse ka ndonjë vështirësi të komunikojë me interpretin për shkak të përdorimit të gjuhës së tretë. Interpreti profesional nuk duhet të ketë ndonjë problem në lidhje me këtë. Mbani shënime.
- Mbani shënim çdo fjalë kyçe që paraqitet gjatë intervistës, dhe përdorni 'Google translate' më vonë për t'i krahasuar ato në gjuhët e ndryshme, për të parë nëse mund të identifikoni ndonjë dallim specifik.

### b. Në gjykatë

- Referojuni intervenimit të Fair Trials në *Vizgirda v. Slovenia* dhe Pjesës II më lartë.
- Arsyetoni: Deklamimi 22 i Direktivës pasqyron supozimin e zakonshëm se interpretimi duhet të ofrohet në një gjuhë amtare të personit të dyshuar ose të akuzuar. Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, autoritetet duhet të jenë të kujdesshme në kontrollin e cilësisë. Mos realizimi i kësaj ka shkakuar cenim (referojuni shembujve të elementeve specifike që duket se kanë shkuar keq gjatë marrjes në pyetje për shkak të përdorimit të gjuhës së tretë, duke u bazuar në shënimet që keni marr). Prandaj, gjykata duhet të ketë kujdes të veçantë kur shqyrton këto dëshmi dhe për të ruajtur mbarëvajtjen e procedurave, duhet të refuzojë mbështetjen në to, përveç në rast se mund të demonstron (p.sh. përmes analizës së audioincizimit) që interpretimi ka ofruar mundësi të plotë që i akuzuari të mbrohet.

<sup>35</sup> *Brozicek v. Italy*, i përmendur më lartë shënim 15.

## IV –PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE ESENCIALE

### A. PROBLEMI

---

Personi i dyshuar ose i akuzuar duhet të njohë çështjen kundër tij në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për mbrojtje. Një person i privuar nga liria duhet të informohet menjëherë për arsyet e arrestimit në mënyrë që të mund të kundërshtojë ndalimin e tij. Nëse personi i dyshuar ose i akuzuar nuk e njeh gjuhën që flitet në vendin përkatës, këto informata duhet të ofrohen në gjuhën e tij. Përveç fazave specifike verbale të procesit penal, siç janë marrja në pyetje në polici dhe seancat gjyqësore, informacioni shpesh do të jetë në formë të një dokumenti, i cili do të duhet të përkthehet.

Në praktikë, anëtarët e LEAP kanë raportuar një sërë çështjesh në lidhje me qasjen në dokumente të përkthyer gjatë procedurave penale. Në disa vende:

- Përkthimi ofrohet vetëm për një listë të kufizuar të dokumenteve, dhe shpesh nuk ka të drejtë ankese për këtë apo të kërkojnë dokumente shtesë; dhe
- është e zakonshme që të ofrohet përkthim me gojë, në vend të përkthimit me shkrim, veçanërisht kur i pandehuri ka avokat (kjo çështje është raportuar në shumë vende).

Nuk ka dyshim që përkthimi me shkrim shpeshherë është më i dobishëm për personin e dyshuar ose të akuzuar sesa shpjegimi me gojë i një dokumenti të shkruar si aktakuzës, gjykimit apo vendimit për mbajtje. Posedimi i një versioni të shkruar të dokumentit i jep mundësi të dyshuarit apo të akuzuarit që ta ekzaminojë atë kur ka kohë, gjë që do t'i ndihmonte atij të përgatisë mbrojtjen.<sup>36</sup> Për një person të ndaluar, posedimi i një vendimi me shkrim do t'i ndihmojë të kuptojë arsyet e ndaljes dhe të përgjigjet kundrejt tyre, gjë që shpeshherë do të duhet ta bëjë pa ndihmën e një avokati.

Megjithatë, çështja e përshkruar më lartë korrespondon me fushat e fleksibilitetit në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila njeh se (i) nuk ekziston një e drejtë e përgjithshme për përkthimin e të gjitha dokumenteve në dosjen e rastit,<sup>37</sup> dhe (ii) “përkthimi” nuk duhet domosdoshmërisht të jetë në formë të shkruar, ku asistenca gjuhësore me gojë konsiderohet e mjaftueshme.<sup>38</sup> Siç do të shohim më poshtë, Direktiva përcakton një të drejtë të qartë për përkthimin e dokumenteve “esenciale”, duke specifikuar disa dokumente të caktuara dhe duke lënë në përgjegjësinë e Shteteve Anëtare që të vlerësojnë se cilat dokumente tjera duhet të përkthehen në varësi të rastit. Megjithatë, sikurse praktika gjyqësore e GJEDNJ, ajo pranon se Shtetet Anëtare mund të ofrojnë edhe përkthim oral apo përmbledhje të dokumenteve. Më poshtë do të shqyrtojmë mënyrat se si Direktiva mund të përdoret për të kundërshtuar çështjet e diskutuara më lartë.

---

<sup>36</sup> Shihni, në këtë kontekst, Ndoshta paragrafin 79 të rastit *Kamasinskiv. Austria*, të përmendur më lartë shënimi 27, paragrafi 79 (i diskutuar më poshtë).

<sup>37</sup> Rasti *Hermi v. Italy*, i përmendur më lartë shënimi 17, paragrafi 70.

<sup>38</sup> Rasti *Husain v. Italy*, Ap. nr. 18913/03 (Gjykim i 24 shkurtit 2005); *Hermi v. Italy*, i përmendur më lartë shënimi 17, paragrafi 70 *Hacioglu v. Romania*, i përmendur më lartë shënimi 10, paragrafi 88

## B. BAZA E KEDNJ-së

---

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në lidhje me përkthimin nuk është shumë e dobishme. Direktiva do të sjellë risi me përkufizimin e saj për “dokumentet esenciale” dhe me dispozita më të qarta për përmbledhje gojore dhe përkthime të redaktuara të një kornize normative shumë më përshkruese. Megjithatë, ne do të shqyrtojmë elementet bazë në lidhje me praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së pasi që ato na ndihmojnë të kuptojmë derogimet në Direktivë.

Pika fillestare është se Neni 6(3)(e), që i referohet ndihmës së një ‘interpreti’, është interpretuar se mbulon përkthimin me shkrim por vetëm në një masë të kufizuar. GJEDNJ deklaron:

*‘[Neni 6(3)(e)] thotë se çdo i pandehur ka të drejtë për ndihmë nga një interpret pa pagesë. Kjo e drejtë zbatohet për deklaratat gojore të bëra në seancat dëgjimore si dhe për materialet e shkruara dhe për procedurat paraprake. Kjo do të thotë se një i akuzuar i cili nuk mund ta kuptojë ose flasë gjuhën që flitet në gjykatë ka të drejtë për ndihmë pa pagesë të një interpreti për përkthimin apo interpretimin e të gjitha dokumenteve ose deklaratave në procedurat e ngritura kundër tij, të cilat është me rëndësi që ai/ajo t’i kuptojë ose t’i përkthejë ato në gjuhën e gjykatës për të përfituar nga gjykimi i drejtë (...) Megjithatë, [Neni 6(3)(e)] nuk shkon aq larg sa të kërkojë përkthim me shkrim të të gjitha pikave të dëshmisë së shkruar ose të dokumenteve zyrtare në procedurë. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se teksti i dispozitave përkatëse i referohet një “interpreti”, jo një “përkthyesi”. Kjo sugjeron se asistenca gjuhësore orale mund të plotësojë kërkesat e konventës’<sup>39</sup>*

Megjithatë GJEDNJ e pranon se preferohet përkthimi me shkrim:

*‘[a] i pandehuri që nuk flet gjuhën e gjykatës në fakt mund të vihet në disavantazh nëse nuk i është ofruar edhe përkthimi me shkrim i aktakuzës në një gjuhë që ai e kupton’<sup>40</sup>*

Përtej kësaj, pak mund të merret nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së për këtë temë. Dispozitat e direktivës janë më përshkruese dhe ofrojnë një bazë më të fuqishme për sigurimin e përkthimit me shkrim.

## C. DISPOZITA RELEVANTE TË DIREKTIVËS

---

### 1. E drejta për përkthim të dokumenteve esenciale

#### a. E drejta e përgjithshme

E drejta për përkthim të dokumenteve esenciale është dhënë në Nenin 3(1), e cila përcakton:

*‘1. Shtetet Anëtare sigurojnë se personave të dyshuar ose të akuzuar të cilët nuk flasin gjuhën e procedurave penale, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, iu ofrohet **përkthim me shkrim** i të gjitha dokumenteve që janë esencial për të siguruar që ata të jenë në gjendje të ushtrorjnë të drejtën e tyre për mbrojtje dhe për të ruajtur mbarëvajtjen e procedurave (theksimi është shtuar).’*

<sup>39</sup> Rasti *Hermi v. Italy*, App. nr. 18114/02 (Gjykim i 18 tetorit 2006), para. 70.

<sup>40</sup> *Kamasinski v. Austria*, përmendur më lartë shënimi 27, para. 70



Në lidhje me këtë dispozitë të përgjithshme do të paraqesim dy pikat në vijim:

- Kjo dispozitë krijon rregullin e përgjithshëm në favor të *përkthimit me shkrim*. Në një konferencë të organizuar nga EULITA u konstatua se termi '*traduction*' në Frëngjisht do të thotë përkthim me shkrim, dhe direktiva përsëri ka specifikuar '*traduction écrite*', me sa duket në përpjekje të qëllim të për të mbitheksuar këtë. Theksi në dokumentet e shkruara në vete është më i fuqishëm se sa sugjerimi tentativë se përkthimi me shkrim mund të nevojitet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
- Ne mendojmë se Direktiva rregullon vetëm përkthimin e dokumenteve në të cilat mbrojtja ka "qasje" në gjuhën origjinale në radhë të parë. Në lidhje me sigurimin e qasjes në dokumente në radhë të parë, shikoni Manualin tonë për Direktivën 2012/13/EU.

## **b. Dokumentet që janë gjithmonë esenciale / dokumentet tjera**

Neni 3 vazhdon duke përshkruar disa dokumente që konsiderohen gjithmonë esenciale, me një obligim për autoritetet që të identifikojnë nëse ka edhe dokumente tjera esenciale:

2. Dokumentet esenciale përfshijnë çdo vendim që privon një person nga liria, çdo akuzë ose aktakuzë, çdo aktgjykim.

3. Autoritetet kompetente vendosin, në secilin rast të caktuar, nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër që është esenciale. Personat e dyshuar ose të akuzuar mund ta paraqesin një kërkesë të arsyetuar për këtë gjë.

Për këto dispozita do të paraqesim vëzhgimet si më poshtë:

- Fakti që Neni 3(3) i referohet "rastit të caktuar" konfirmon që pyetja nëse një dokument është esenciale varet nga specifikat e rastit. Është e pamundur të përcaktohet nëse një pjesë e provave (p.sh. deklarata e dëshmitarit) është gjithmonë jo-esenciale.
- Përcaktimi i një dokumenti esenciale për qëllim të arsyetimit se një dokument i caktuar duhet të përkthehet në një rast të caktuar është dhënë në Nenin 3(1), i cili thotë se 'të gjitha dokumentet që janë esenciale për të siguruar që ata janë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u mbrojtur dhe për të ruajtur mbarëvajtjen e procedurave'.

## **2. Përkthimi i pjesshëm**

Neni 3(4) i Direktivës thotë:

'4. Nuk është e nevojshme të përkthehen pasueset e dokumenteve të cilat nuk janë relevante sa i përket qëllimit që personit të dyshuar apo të akuzuar ti mundësohet që të jenë në dijeni për rastin kundër tij/saj.'

Më poshtë janë paraqitur mendimet tona për këtë dispozitë:

- Pjesë të caktuara të përkthimit mund të hiqen nëse konsiderohet se nuk janë 'relevante'. Referencimi i 'rastit kundër' personit të dyshuar ose akuzuar sugjeron se dispozita mund ta ketë fjalën për përkthimin e pjesëve inkriminuese të një dokumenti.
- Megjithatë, pjesë tjera të dokumentit mund të jenë relevante për të siguruar mbarëvajtjen e procedurave. Pjesë tjera të deklaratave të dëshmitarit mundën, për shembull, të zbulojnë

gënjeshtra të cilat i dyshuari do të mund t'i identifikonte po të ishte në posedim të përkthimit. Avokati mund të marr përsipër shqyrtimin e pjesëve tjera të dokumentit, por pa ndihmën e klientit mund të mos e dijë nëse pasuset e tjera janë relevante apo jo.

- Ngjashëm, edhe pse kjo nuk paraqitet si “përfashtim”, sugjerojmë që zbatimi i kësaj dispozite të trajtohet me kujdes, pasi që kufizon mundësinë e të dyshuarit që të familjarizohet me dokumentin i cili është cilësuar si esencjal për ushtrimin e të drejtës për mbrojtje.

### 3. Përfashtimi i “përkthimit me gojë/përmbledhjes”

Neni 3(7) thotë:

'7. Si përfashtim nga rregullat e përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3 dhe 6, përkthimi me gojë apo përmbledhja me gojë e një dokumenti esencjal mund të ofrohet në vend të përkthimit me shkrim me kusht që një përkthim me gojë i tillë ose përmbledhje me gojë e tillë nuk cenon mbarëvajtjen e procedurave (...)'.

Komentet tona në lidhje me këtë dispozitë janë:

- Siç u diskutua më lartë, Neni 3(7) përcakton një rregull të qartë në favor të përkthimit me “shkrim”.
- Përmes kësaj dispozite Direktiva lejon Shtetet Anëtare të ofrojnë një përkthim apo përmbledhje me gojë të një dokumenti esencjal në vend të sigurimit të një përkthimi me shkrim. Megjithatë, kjo shprehimisht është paraqitur si “përfashtim nga rregulli i përgjithshëm”. Prandaj mbetet të interpretohet në mënyrë të kufizuar.

### 4. E drejta për të kërkuar përkthim dhe e drejta për të kundërshtuar refuzimin e kërkesës

Sërisht do të paraqesim Nenin 3(3), si dhe Nenin 3(5):

'3. Autoritetet kompetente, në çdo rast të caktuar, vendosin nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër që është esencjal. **Personat e dyshuar ose të akuzuar mund ta paraqesin një kërkesë të arsyetuar për këtë gjë** (theksimi është shtuar). (...)

5. Shtetet Anëtare sigurojnë se në përputhje me procedurat e të drejtës kombëtare, personat e dyshuar ose të akuzuar kanë të drejtë të kundërshtojnë një vendim që konstaton se nuk ka nevojë për përkthim të dokumenteve apo pasazheve të tyre (...)'.

Sërisht, këto dispozita lënë shumë gjëra pa përgjigje:

- Nuk ka asnjë indikacion për personin të cilit duhet t'i dërgohet “kërkesa e adresuar”.
- As nuk ka ndonjë indikacion për natyrën e autoritetit që është kompetent për të dëgjuar “kundërshtimin” e vendimit që konstaton se nuk ka nevojë për përkthim të dokumenteve apo pjesëve të tyre.
- Prandaj, këto çështje u mbesin Shteteve Anëtare t'i organizojnë, por sipas Nenit 47 të Kartës dhe sipas parimit të përgjithshëm të mbrojtjes efektive gjyqësore, duhet supozuar se refuzimi i përkthimit duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrës efektive gjyqësore.
- Logjikisht kjo rezulton nga kërkesa për të paraqitur një “kërkesë të arsyetuar” dhe nga mundësia

për të kundërshtuar (apeluar) një vendim negativ dhe se autoriteti refuzues duhet të ofrojë arsye për refuzimin. Kjo rrjedh nga tradita e të drejtës për mbrojtje në kuadër të së drejtës të BE-së, e cila kërkon dhënien e arsyeve mbi të cilat merret një vendim për t'i bërë të mundur personit të prekur që t'i mbroj të drejtat e tij.<sup>41</sup>

## D. PËRDORIMI I DIREKTIVËS NË PRAKTIKË

### 1. Identifikimi i dokumenteve për të cilat dëshironi përkthime

Në Seksionin 2 më poshtë do të shqyrtojmë disa nga argumentimet ligjore që mund të bëhen për të argumentuar se Direktiva ju jep të drejtën për përkthimin e një dokumenti. Sidoqoftë, para kësaj duhet të vendosni se cilat dokumente *i dëshironi*, dhe pastaj shqyrtoni nëse Direktiva ju ofron këtë të drejtë. Përkthimet mund t'ju nevojiten për arsye specifike (p.sh. nëse përmban pjesë kyçe të akuzës ose nëse është deklaratë e dëshmitarit kyç për të cilën klientit i duhet kohë që të shqyrtoj dhe të kontrolloj përmbajtjen e saj). Por për dokumente të tjera, sfida është që pa u konsultuar me klientin, nuk mund ta dini nëse dokumenti ose një pjesë e tij përmban informata kyçe. Megjithatë, klienti nuk mund të ndihmojë nëse nuk sigurohet përkthimi (i njërit apo llojit tjetër). Ne sugjerojmë që ky është një test i rëndësishëm që duhet bërë: nëse nuk mund ta përcaktoni vlerën e një dokumenti pa kontributin e klientit, duhet të kërkonit përkthimin.

→ Identifikoni dokumentet që ju duhen:

- A është ky një dokument kyç, siç është njoftimi i dyshimit të dhënë me rastin e arrestimit, urdhër-arrestit, aktakuzës apo aktgjykimit?
- A është një deklaratë e dëshmitarit që bie ndesh me versionin e ngjarjeve të klientit tuaj dhe të cilën ai duhet ta shohë për t'ju treguar se çfarë është gabim?
- A është klienti në paraburgim? A nënkupton kjo se nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar me klientin tuaj sa i përket përmbajtjes së dokumentit përkatës?

### 2. Parashtrimi i kërkesës

Pasi të keni vendosur se cilat dokumente i dëshironi, duhet të parashtroni kërkesë për ato. Këtu, bazoheni në nenin 3(3) të Direktivës që ju jep të drejtën për të parashtruar një “kërkesë të arsyetuar”. Siç është e qartë nga teksti i Direktivës, nuk ka ndonjë kërkesë specifike se kush duhet të jetë përgjegjës për të vendosur se cilat dokumente janë esenciale, kërkesat dëgjimore apo kundërshtimet. Parimisht, kjo është çështje që duhet të organizohet nga shtetet anëtare. Në punën tuaj përgatitore (shih Hyrjen) do të keni identifikuar cili është organi kompetent.

Është e mundur që, sipas ligjit tuaj kombëtar, nuk ka organ të caktuar posaçërisht për të kërkuar përkthimin. Nëse nuk janë ndërmarrë hapa për zbatimin e Direktivës, kjo mund të jetë problematike dhe mund t'ju duhet të bindni një autoritet që ata duhet ta marrin parasysh kërkesën. Kjo është pika e parë që trajtohet më poshtë.

<sup>41</sup> Shihni Rastet e Përbashkëta C-584/10 P etj., Komisioni dhe të tjerë. v. *Kadi* [ECLI:EU:C:213:518], para. 100.

## a. Elementet themelore

Nuk ka asnjë indikacion në tekstin e Direktivës në lidhje me atë nëse ju duhet të jeni në gjendje të paraqisni një kërkesë me shkrim ose me gojë dhe kjo do të qeveriset nga rregullat përkatëse në procedurën tuaj penale. Po kështu, çështjet që do të mbulohen nga kërkesa do të përcaktohen pjesërisht nga pozita e ligjit kombëtar, por është e mundur të bëhen disa sugjerime themelore:

- Bëni një kërkesë të arsyetuar me shkrim.
- Theksoni në mënyrë shprehimore se po e bëni kërkesën sipas nenit 3(3) të Direktivës, e cila ju jep të drejtën që të kërkonti dokumentet esenciale, si dhe çdo dispozitë relevante kombëtare
- Deklaroni që nëse autoriteti refuzon të ofroj përkthimin, ju kërkonti një vendim të arsyetuar (kjo do të jetë e dobishme nëse duhet të kundërshtoni vendimin).
- Theksoni arsyen pse dokumentet që kërkonti ju janë esenciale.
- Theksoni arsyen pse përkthimi me gojë do të ishte i pamjaftueshëm.

## b. Përmbajtja e kërkesës

### i. *Unë kam të drejtë ta bëj këtë kërkesë*

Natyrisht, nëse një procedurë e tillë është paraparë në ligjin kombëtar, nuk keni nevojë ta bindni organin që të shqyrtoj kërkesën tuaj. Nëse nuk ka asgjë të paraparë në mënyrë shprehimore në ligjet kombëtare sa i përket kërkesës për përkthimin e dokumenteve, përveç atyre të përcaktuara me ligj detyrimisht, ju duhet t'i rikujtoni autoritetit detyrimet e tij sipas Direktivës. Ju duhet t'i shpjegoni autoriteteve se, pavarësisht nga ajo që parashikohet në ligjin kombëtar, ata duhet ta dëgjojnë kërkesën tuaj:

- Argumentoni: Neni 3(3) i Direktivës detyron autoritetet kombëtare të shqyrtojnë në baza rast pas rasti nëse dokumenti është esencial dhe i jep të drejtë të dyshuarit ose të akuzuarit të bëjë një kërkesë të arsyetuar për një dokument esencial. Prandaj, kjo kërkesë duhet marrë parasysht.

Mund t'ju duhet të parashtoni këtë kërkesë tek persona të ndryshëm (p.sh. prokurori, gjykatësi hetues, policia). Nëse këto autoritete refuzojnë të marrin parasysht kërkesën tuaj, kjo në vetvete paraqet shkelje e Direktivës dhe si e tillë duhet të jetë objekt i një ankese gjyqësore (shih seksionin “Kundërshtimi i vendimeve negative” më poshtë). Për momentin, do të supozojmë se ekziston procedura për të kërkuar dokumente të tjera, ose që autoriteti ka pranuar të marrë në konsideratë kërkesën tuaj. Ju tani duhet të argumentoni pse keni të drejtë në atë dokument.

### ii. *Dokumentet e detyrueshme*

Në mënyrë që të kërkonti një të drejtë sipas Direktivës, duhet të vërtetoni se dokumenti është një “dokument esencial” brenda kuptimit të nenit 3(1). Në rastin e akuzave, aktakuzave, aktgjykimeve dhe vendimeve për privimin nga liria, kjo është e rregulluar shprehimisht:

'2. Dokumentet esenciale do të përfshijnë çdo vendim që privon personin nga liria, çdo akuzë ose aktakuzë, çdo aktgjykim.'

Nëse dokumenti për të cilin nuk keni përkthim është një nga këto, duhet të këmbëngulni për përkthim:

- Argumentoni: Neni 3(2) i jep të drejtë të dyshuarit për përkthimin e çdo vendimi që privon një person nga liria, çdo akuzë apo aktakuzë dhe çdo aktgjykim. Një dokument i tillë, përkatësisht [...], nuk është i sigurt. Pavarësisht nga ajo që përcaktohet në ligjin kombëtar, i dyshuari ka të drejtë në këtë dokument.

Nëse organi refuzon në bazë të asaj se nuk ka kompetenca për të urdhëruar përkthimin, duhet të kundërshtoni vendimin. Shikoni seksionin "kundërshtimi i vendimeve negative" më poshtë).

### **iii. Dokumentet tjera esenciale**

Për dokumentet që nuk janë të përfshira në nenin 3(2) të Direktivës, ju duhet të vërtetoni se ato janë 'esenciale'. Përkufizimi i plotë është dhënë nga neni 3(1):

'(...)dokumente që janë esenciale për t'u garantuar atyre mundësinë e ushtrimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe për të siguruar mbarëvajtjen e procedurave'

Siç u përmend më lart, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nuk theksohen në mënyrë të veçantë dokumentet e shkruara, prandaj në këtë seksion nuk propozojmë argumente të bazuara në raste specifike. Ju sugjerojmë që të përqendroni analizën tuaj në aspektin praktik të asaj se mungesa e përkthimit, duke u bazuar në natyrën dhe vlerën e dokumentit, e pengon klientin tuaj nga ushtrimi i të drejtave të mbrojtjes në mënyrë efektive.

#### **▪ Transkriptet/procesverbalet e intervistimit nga policia**

Ndoshta një prej dokumenteve kyçe për të cilin klienti ka nevojë të përkthehet është transkripta ose procesverbali i asaj që ai ka thënë gjatë marrjes në pyetje nga policia. Ky informacion do të përdoret dhe mund të ketë rëndësi madhore si në fazën e procedurës paraprake ashtu dhe në fazën e gjyqësorisë. Si avokat, ju nuk e dini nëse ky dokument përmban pasaktësi në krahasim me atë që është thënë në të vërtetë, dhe mund të jetë që dokumenti është përmbledhur nga një përkthyes në kohën e intervistimit

- Argumentoni: Të dyshuarit i nevojitet përkthimi i procesverbalit të asaj që ai ka thënë gjatë intervistës, veçanërisht nëse thuhet se ai ka bërë deklaratë inkriminuese ose se deklaratat e tij janë në kundërshtim me atë që thuhet nga dëshmitarët e tjerë.

#### **▪ Prova mbështetëse kryesore**

Po ashtu, i dyshuari ose i akuzuari duhet të jetë në gjendje të lexojë përkthimet e provave kryesore të përdorura për të mbështetur disa nga dokumentet të cilat duhet të përkthehen sipas nenit 3(2). Për shembull, nëse një vendim për paraburgim bazohet kryesisht në një ose dy deklaratat e dëshmitarëve, mundësia e të dyshuarit për të ankimuar paraburgimin mund të varet

nga aftësia e tij që të lexoj dokumentet e tilla mbështetëse. Po ashtu, mund të jetë e nevojshme që dëshmitë kyçe mbi të cilat bazohet aktakuza të përkthehen ashtu që personi të komentojë mbi të njëjtat në mënyrë efektive.

- Argumentoni: Me qëllimin që të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtat e mbrojtjes, i dyshuari duhet të ketë qasje në provat mbështetëse kyçe në të cilat bazohen dokumentet e listuara në nenin 3(2) të Direktivës. Kjo mund të përfshijë deklaratat e dëshmitarëve dhe/ose ekspertizat mbi të cilat bazohet vendimi për paraburgimi ose aktakuza.

### 3. Kundërshtimi i vendimeve negative

Nëse refuzohet vendimi, duhet parashtroni ankesë, siç parashihet me nenin 3(5) të Direktivës. Siç është përmendur më lart, nuk specifikohet se para cilit autoritet duhet të parashtrohet kjo ankesë. Çështje të ndryshme mund të lindin sipas mënyrës së organizimit të sistemit në vendin tuaj.

Para se të shikojmë çdo mundësi, vlen të kujtojmë parimin e "mbrojtjes efektive gjyqësore" të shprehur në **nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së**, e cila parasheh:

'Kujtdo të cilit i janë cenuar të drejtat dhe lirit e garantuara sipas të drejtës së Bashkimit, gëzon të drejtën e mjetit efektiv ligjor para një tribunali...'

Në thelb, ideja është se "kundërshtimi" që keni të drejtë të bëni sipas nenit 3(5) të Direktivës duhet bërë para një gjykate. Ka edhe shumë gjëra në lidhje me mbrojtjen efektive ligjore, dhe mund të na kontaktoni nëse dëshironi ndihmë të mëtejshme në këtë rast të veçantë.

#### a. Këmbëngulni për shqyrtim gjyqësor

Në këtë situatë, edhe nëse kodi i procedurës penale nuk parasheh të drejtën e kundërshtimit kundër vendimit të prokurorit, duhet të kundërshtoni këtë para gjykatës më të përshtatshme me juridiksion të përgjithshëm (p.sh. gjykata administrative, gjykatësi hetues, etj.) duke kërkuar të drejtën për këtë sipas Direktivës. Refuzimi i tyre në bazë të juridiksionit mund të jetë i apelueshëm dhe kjo mund t'ju lejojë të dërgoni çështjen para një gjykate më të lartë e cila do të ishte më e pranueshme për argumentet rreth të drejtës së BE-së.

➔ Provoni çdo mjet në dispozicion për ankimim:

- A ka ndonjë mjet juridik të përgjithshëm si kundërshtimi administrativ?
- Edhe nëse nuk ekziston ndonjë mekanizëm, bëjeni kërkesën tek gjykata penale/gjykatësi hetues përgjegjës për rastin.

#### b. Arsyet e kundërshtimit

##### i. Refuzimet e paarsyeshme nuk janë të pranueshme

Praktikuesit shpesh raportojnë tek ne se vendimet procedurale, në të gjitha fushat (p.sh. paraburgimi), nuk kanë arsyetim adekuat. Nëse kjo manifestohet në këtë kontekst, duhet të ngrini

këtë çështje:

- Kontaktoni të njëjtin organ që ka marrë vendimin ose kundërshtojeni atë drejtpërsëdrejti.
- Argumentoni: sipas Direktivës organi kërkohet në mënyrë implicite të japë arsye. I dyshuari ka paraqitur një "kërkesë të arsyetuar" sipas nenit 3(3) dhe për të "kundërshtuar" këtë vendim siç parashikohet në nenin 3(5), ai duhet të ketë arsye për të. Prandaj, organi duhet të rishikojë vendimet e tij.<sup>42</sup>

## **ii. Vendimi mbështetet në mundësinë e "përkthimit verbal"**

Kjo duket se mund të jetë një nga bazat kryesore mbi të cilën refuzohen përkthimet me shkrim: argumenti qëndron në atë se funksioni i përkthimit është të mundësojë personin të kuptojë çështjen e ngritur kundër tij/saj dhe se kjo mund të arrihet përmes një shpjegimi verbal. Argumentet për këtë bien në fushëveprimin e nenit 3(7) të Direktivës, i cili siç u shpjegua më lart, krijon një përjashtim nga rregulli në favor të përkthimeve me shkrim. Mbani parasysh edhe dispozitat e nenit 52 të Kartës:

‘Çdo kufizim në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Kartë duhet të parashikohet me ligj dhe të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Duke iu nënshtruar parimit të proporcionalitetit, kufizimet mund të bëhen vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe në të vërtetë përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi Evropian ose nevoja për respektimin e të drejtave dhe lirive të tjerëve’.

Duke pasur parasysh se e drejta e shprehur në nenin 3(7) të Direktivës për "përkthime me shkrim" është një përbërës i së drejtës për një gjykim të drejtë të mbrojtur me nenin 47 të Kartës, "përjashtimi" me anë të të cilit një "përkthim me gojë ose përmbledhje me gojë mund të ofrohet duhet të trajtohet si e tillë: një kompetencë e jashtëzakonshme e cila duhet të zbatohet vetëm në masën e nevojshme (objektivi i interesit të përgjithshëm do të jetë, natyrisht, administrimi efektiv i drejtësisë). Do të sugjerohet një argument përgjatë këtyre linjave:

➔ Argumentoni: Neni 3(1) i Direktivës i jep të drejtë të dyshuarit ose të akuzuarit për "përkthim me shkrim" të dokumenteve esenciale. Kompetenca në nenin 3(7) është përjashtim nga ky rregull dhe përbën kufizim të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 47 të Kartës, i cili duhet të zbatohet në mënyrë të kufizuar dhe proporcionale dhe jo si rregull i përgjithshëm.

Kjo qasje përfshin disa argumente të tjera:

<sup>42</sup>Shih, në këtë drejtim, Rastet e Bashkuara C-584/10 P, C-593/10 P dhe C-595/10 P *Kadi v Commission* [ECLI:EU:C:2013:518](https://eur-lex.europa.eu/eli/cj/oj/2013/518).

- ➔ Argumentohet: *Rregulli i përgjithshëm* i ligjit kombëtar sipas të cilit jepen gjithmonë përkthime verbale është në kundërshtim me Direktivën dhe duhet të ofrohet përkthimi me shkrim, përveç nëse bëhet thirrja në përjashtimin nga neni 3(7) në mënyrë legjitime.
- ➔ Argumentoni: Arsyet e interesit publik (administrimi i drejtësisë) që synojnë të parandalojnë përkthimin me shkrim duhet të jenë të balancuara kundrejt interesave të të pandehurit. Kjo nënkupton që duhet pasur parasysh gjatësinë e dokumentit dhe mundësinë e përkthimit së paku të pasazheve të caktuara të dokumentit me shkrim, siç parashikohet me nenin 3(4).

Përtej kësaj, sugjerojmë që analiza të varet nga kriteri në nenin 3(7) që përcakton se mund të sigurohet një përkthim ose përmbledhje verbale –

“me kushtin që ky përkthim me gojë apo kjo përmbledhje të mos cenojë mbarëvajtjen e procesit”.

Prandaj, argumentoni se si dokumenti specifik, nëse nuk sigurohet me shkrim, do të rrezikojë paragjykimin e rregullsisë së procedurës:

- ➔ Theksoni arsyet pse i dyshuari ka nevojë për vetë dokumentin dhe mundësinë që ta shqyrtojë atë vetë, në mënyrë që të përgatisë një mbrojtje efektive, p.sh.
  - Është një deklaratë e dëshmitarit kryesor dhe i dyshuari duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë përmbajtjen në mënyrë që t'ju udhëzojë në lidhje me mospërputhjet ose të pavërtetat në të.



## PËRFUNDIM

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mbi këtë çështje është kufizuar deri në një masë dhe vuan nga sasia e kufizuar e provave që GJEDNJ zakonisht ka në dispozicion gjatë marrjes së vendimeve në lidhje me atë nëse është gëzuar dhe respektuar e drejta e asistencës gjuhësore. Direktiva, në vendosjen e standardeve të përbashkëta në fushën e interpretimit dhe përkthimit, siguron një kornizë më të strukturuar normative brenda së cilës duhet të merret dhe të kontrollohet nga gjykata vendim-marrja vendore.

Fair Trials shpreson që kjo Direktivë mund të ndihmojë me të vërtetë mbrojtjen penale. Qytetarët jo-rezident janë historikisht përfitues të së drejtës së BE-së - si në rastin e *Bickel dhe Franz*, ku dispozitat e Traktatit të BE-së u përdorën për të parandaluar diskriminimin kundër qytetarëve jo-rezident në ofrimin e interpretimit në procedurat gjyqësore. Shpresojmë se tani që BE-ja ka vendosur t'u ofroj mbrojtjen e të drejtës së BE-së të pandehurve që nuk flasin gjuhën amtare, këta të fundit do të gëzojnë mbrojtje të fuqishme.

Në pritje të interpretimit të Direktivës nga GJDBE-ja, përgjatë gjithë këtij manuali, jemi munduar të bëjmë të qartë se kur jemi bazuar në Direktivë si dhe jemi përpjekur të themi në mënyrë eksplicite prej nga ka ardhur qasja jonë ligjore. Megjithatë, pranojmë plotësisht se mund të ketë pikëpamje të tjera. Ju lutemi mos hezitoni të na jepni informata kthyesë rreth këtij manuali: na tregoni nëse ka qenë i dobishëm, nëse nuk pajtoheni me të si dhe arsyet pse.

Gjithashtu, ju inkurajojmë që të angazhoheni me Fair Trials dhe rrjetet që ne koordinojmë:

- Na kontaktoni për të na informuar për përvojën tuaj duke u referuar në këtë Direktivë.
- Na tregoni nëse gjykatat nxjerrin vendime pozitive duke zbatuar Direktivat.
- Nëse lindin pyetje mbi interpretimin, shqyrtoni rrugën e GJDBE-së: shih manualin e përdorimit të së drejtës së BE-së, dokumentin tonë të vitit 2014 për qasjet strategjike të GJDBE-së<sup>43</sup> dhe videon e trajnimit tonë në internet mbi procedurën e vendimeve paraprake në praktikën penale.<sup>44</sup>
- Vizitoni rregullisht faqen tonë të internetit [www.fairtrials.org](http://www.fairtrials.org) për përditësime mbi zhvillimet kyçe në lidhje me Direktivat, si dhe lajmet mbi trajnimet personale.
- Drejtohuni tek ne nëse nuk arrini ndokund me gjykatat, sepse ne mund të eksplorojmë mundësi të tjera si dërgimi i ankesave në Komisionin Evropian.
- Përfshihuni me shtyrjen para të çështjeve në kontekstin e vendor: shihni dokumentin tonë *Drejt Lëvizjes së BE-së mbi të Drejtat e Mbrojtjes së*<sup>45</sup> për ide konkrete rreth neneve, çështjeve gjyqësore, konferencave etj.

Fair Trials Evropë

Paneli këshillimor i ekspertëve ligjor

mars 2015

<sup>43</sup> Fair Trials, *Qasjet strategjike në proceset gjyqësore përpara GJDBE-së në Direktivat e Udhërrëfyesit dhe EAW, 2014, e qasshme në* <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/140818-CJEU-meeting-report.pdf>.

<sup>44</sup> E qasshme në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

<sup>45</sup> LEAP, *Strategjitë për zbatimin e Direktivave të Udhërrëfyesit: Drejt një Lëvizje të të Drejtave të Mbrojtjes së BE-së, shkurt 2015, E qasshme në:* <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/5A-IMPLEMENTATION-MOVEMENT-PAPER.pdf>.



Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Programit të Drejtësisë Penale të Komisionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fair Trials Europe dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për t'i pasqyruar pikëpamjet e Komisionit Evropian

